

TË LIRË
NGA FRIKA

TË LIRË


NGA
DHUNA

Konventa e Këshillit të Evropës
për parandalimin dhe luftimin
e dhunës kundër grave
dhe dhunës në familje CETS. Nr. 210

Manual për parlamentarët

Konventa e Këshillit të Evropës
për parandalimin dhe luftimin
e dhunës kundër grave dhe
dhunës në familje
(Konventa e Stambollit)





COUNCIL OF EUROPE CONSEIL DE L'EUROPE

Manual për parlamentarët

Konventa e Këshillit të Evropës
për parandalimin dhe luftimin
e dhunës kundër grave dhe
dhunës në familje

(Konventa e Stambollit)

Dokument i përgatitur nga Hilary Fisher, konsulente eksperte, në bashkëpunim me Sekretariatit e Komisionit për Barazinë dhe Mosdiskriminimin pranë Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës

Përkthimi në shqip u mundësua nga Z. Ilir Baçi, ndërsa redaktimi nga Znj. Emira Shkurti L.L.M, M.A.S. Ky përkthim është publikuar në konsultim me Këshillin e Evropës: © Këshilli i Evropës.

Përkthimi në shqip dhe botimi i këtij doracaku u bë i mundur nga UN Women përmes mbështetjes financiare të Fondit të Koherencës së OKB-së në Shqipëri me kontributin e Agjencisë Suedeze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida).

“UN Women është organizata e OKB-së përkushtuar barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave. UN Women është kampion botëror për gratë dhe vajzat në arritjen e objektivave mbi barazinë gjinore dhe nxitjen e progresit për fuqizimin e tyre.” (www.unwomen.org)

Ballina dhe faqesja: Drejtoria për Prodhimin e Dokumenteve dhe Publikimeve, Këshilli i Evropës

Sekretariati i Komisionit për Barazinë dhe Mosdiskriminimin

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës

F-67075 Strasbourg Cedex

Tel : +33 (0)3 90 21 47 78

Faks: +33 (0)3 90 21 56 49

<http://assembly.coe.int>

© Këshilli i Evropës

Përmbajtja

Mbi Këshillin e Evropës	5
Mbi Asamblenë Parlamentare dhe Rrjetin Parlamentar “Gra të lira prej dhunës”	7
Parathënie e Presidentit të Asamblesë Parlamentare	9
Thirrje e Raportuesit të Përgjithshëm për dhunën ndaj grave	11
Roli i parlamentarëve në mbështetje të Konventës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje”	13
Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe të dhunës në familje” (CETS nr. 210, “Konventa e Stambollit”)	15
Përse duhet një konventë	15
Çfarë mbulon Konventa	19
Politikat e integruara dhe mbledhja e të dhënave	22
Parandalimi	24
Mbrojtja dhe mbështetja	27
Dispozitat materiale	30
Hetimi, ndjekja penale, dispozitat procedurale dhe masat mbrojtëse	39
Migrimi dhe azili	41
Mekanizmi i monitorimit	43
Marrëdhëniet me instrumentet e tjera ndërkombëtare	45

Klauzola të fundit	45
Pasthënie e Zëvendëssekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.....	47

Shtojca

Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe të dhunës në familje” (CETS nr. 210).....	49
Lista e rezolutave dhe rekomandimeve të Asamblesë së Përgjithshme për dhunën kundër grave (2000-2012)	93
Lista e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në lidhje me dhunën kundër grave	94
Lista e instrumenteve dhe standardeve të tjera ndërkombëtare të kësaj fushe	95

Mbi Këshillin e Evropës

Këshilli i Evropës ka 47 shtete anëtare, duke mbuluar thuajse të gjithë kontinentin e Evropës. Këshilli i Evropës synon zhvillimin e parimeve të përbashkëta demokratike dhe ligjore mbështetur në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut) dhe në tekstet e tjera mbështetëse për mbrojtjen e individëve, duke përfshirë gratë dhe vajzat. Prej viteve '90 të shekullit XX, Këshilli i Evropës nxit aktivisht mbrojtjen e grave dhe të vajzave nga dhuna me bazë gjinore, më konkretisht përmes miratimit të Rekomandimit (2002)5 për mbrojtjen e grave nga dhuna, dhe përmes zhvillimit të një fushate mbarëevropiane lidhur me dhunën ndaj grave duke përfshirë edhe dhunën në familje gjatë periudhës 2006-2008.

www.coe.int/conventionviolence
conventionviolence@coe.int

Mbi Asamblenë Parlamentare dhe Rrjetin Parlamentar “Gra të lira prej dhunës”



Parlamentarët që përbëjnë Asamblenë Parlamentare janë nga parlamentet kombëtare të 47 shteteve anëtare të Këshillit të Europës. Ata mbledhen katër herë në vit për të diskutuar për çështje tematike dhe për t'u kërkuar qeverive evropiane të marrin nisma dhe të raportojnë në lidhje me to. Këta parlamentarë flasin në emër të tetëqind milion evropianëve të cilët i kanë zgjedhur.

Rrjeti Parlamentar “Gra të lira prej dhunës” është ngritur fillimisht në kuadër të fushatës për të luftuar dhunën ndaj grave (2006-2008). Gjatë kësaj periudhe rreth 40 parlamente kombëtare kanë zhvilluar më shumë se dyqind veprimtari në mbarë Evropën, për të dënuar dhunën ndaj grave, për të rritur ndërgjegjësimin e parlamentarëve dhe të publikut të gjerë, për të ndryshuar aktet ligjore në mënyrë që të pengohet kjo e keqe, për t’i mbrojtur më mirë viktimat dhe për të ndjekur penalisht autorët e dhunës. Me Rezolutën 1635 (2008) “Për luftën ndaj dhunës ndaj grave: drejt një konvente të Këshillit të Evropës”, Asambleja vendosi që mbyllja e fushatës të mos ishte mbyllje e Rrjetit. Përkundrazi, kjo nismë dhe ky instrument i fuqishëm do të ishte me shumë rëndësi për të rritur shkëmbimin e informacioneve mes parlamentareve dhe për bashkërendimin e veprimeve të përbashkëta.

Ky rrjet tani përbëhet nga anëtarë të delegacioneve parlamentare të shteteve anëtare dhe të vendeve me status vëzhgues në Asamblenë Parlamentare, si edhe të delegacioneve të Partnerëve për Demokraci. Rrjeti drejtohet nga Raportuesi i Përgjithshëm për dhunën ndaj grave, i cili vepron si koordinator politik i Rrjetit. Që prej miratimit të Konventës së Stambollit nga Komiteti i Ministrave, Rrjeti i ka vendosur vetes si objektiv parësor vazhdimin e promovimit të saj, në mënyrë që të hyjë në fuqi pa vonesë.

www.assembly.coe.int/stopviolence/
womenfreefromviolence@coe.int

Parathënie e Presidentit të Asamblesë Parlamentare

Të veprojmë tani për të luftuar dhunën ndaj grave!

Sot me miliona gra në mbarë botën ende pësojnë dhunë fizike dhe psikologjike dhe privohen nga e drejta më e rëndësishme nga të gjitha të drejtat: e drejta për të jetuar pa dhunë. Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë të papranueshme dhe të patolerueshme. E megjithatë, një në pesë gra në Evropë ka pësuar, po pëson ose ka mundësi të pësojë dhunë. Vetëm ta dënojmë këtë dukuri nuk mjafton më: duhen vepra! Përgjegjësia politike na kërkon t'u japim fund këtyre shkeljeve të të drejtave themelore.



Pas vitesh të tëra angazhimesh, me ngritjen e një rrjeti parlamentarësh dhe një fushate të gjerë nga viti 2006 deri në vitin 2008, Këshilli i Evropës i ka dhënë tashmë një formë konkrete veprimit të tij përmes miratimit të Konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe kundër dhunës në familje, e cila është hapur për nënshkrim më 11 maj 2011 në Stamboll.

Konventa e Stambollit është një instrument i gjithanshëm ndërkombëtar ku parashikohet mbrojtja, parandalimi, ndjekja penale dhe miratimi i politikave në fushën e luftës kundër dhunës ndaj grave dhe kundër dhunës në familje. Konventa mund ta përmirësojë dhe do ta përmirësojë statusin e grave dhe respektimin e të drejtave të njeriut, nëse ratifikohet nga një numër i mjaftueshëm vendesh. Ratifikimi dhe vënia në jetë e Konventës është një shprehje

e qartë e vlerësimit tonë për nevojën që kanë viktimat për drejtësi dhe solidaritet.

Përmes këtij publikimi do t'ju bëja thirrje të gjithë parlamentarëve të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe më gjerë, që t'i rrisin përpjekjet për nxitjen e nënshkrimit, ratifikimit dhe vënies në jetë të Konventës së Stambollit. Duhet të kujdesemi që kjo Konventë të mos mbetet në heshtje por të funksionojë si një instrument i gjallë e i dobishëm i cili të jetë simbol i fitores ndaj dhunës.

Ju ftoj ta përdorni këtë manual si një mjet praktik për të bërë të mundur që Konventa të kuptohet më qartë. Manuali mund të përdoret për të orientuar veprimtaritë që promovojnë Konventën, duke ofruar çelësin për të kuptuar këtë instrument të veçantë. Do t'ju lutesha gjithashtu të ndiqnit punën e Rrjetit Parlamentar "Gra pa dhunë", i cili zhvillon mbledhje të rregullta në Strasburg. Prej vitit 2006, anëtarët e këtij Rrjeti janë flamurtarët e luftës kundër dhunës ndaj grave, duke bërë ndërgjegjësime në parlamentet përkatëse të tyre dhe në publik. Anëtarët e këtij rrjeti tani po e përqendrojnë punën tek promovimi i Konventës së Stambollit.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës tani ka një zëdhënës zyrtar për dhunën ndaj grave, zotin Mendes Bota, i emëruar si Raportuesi i Përgjithshëm për dhunën ndaj grave. Do t'ju nxisja të shfrytëzoni shërbimet e tij prej eksperti në lidhje me këtë çështje, ndërsa unë garantoj mbështetjen time të plotë për të.

Duhet medoemos të bashkohemi të gjithë kundër dhunës, të dëshmojnë fuqinë tonë dhe t'i japim një shtytje të vërtetë politike punës për ta vënë në jetë Konventën. Ta bëjmë vitin 2013 një vit të shënuar në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe kundër dhunës në familje. Le të veprohet tani. Le të ratifikohet Konventa.

Jean-Claude Mignon
*President i Asamblesë Parlamentare
të Këshillit të Evropës*

Thirrje e Raportuesit të Përgjithshëm kundër dhunës ndaj grave

Të jetosh pa dhunë është e drejta e parë e njeriut

Dhuna ndaj grave dhe vajzave, duke përfshirë edhe dhunën në familje, është një prej formave më të rënda të shkeljeve të të drejtave të njeriut në Evropë. Është edhe një prej krimeve më të përhapura. E megjithatë, presioni shoqëror është kaq i fortë sa që shumë viktime e pranojnë këtë dhunë si një fakt të pashmangshëm të jetës dhe nuk e kallëzojnë. Ka viktime të tjera, që e gjejnë guximin për t'u kërkuar ndihmë autoriteteve, por që ndonjëherë kthehen pas pa i marrë kush seriozisht. Por ka edhe viktime të tjera që nuk gjejnë dot mbrojtje e drejtësi, për shkak të dobësive dhe mangësive të kuadrit ligjor dhe politik të vendit ku jetojnë.

Jam krenar që Këshilli i Evropës vazhdon t'i qëndrojë besnik rolit dhe mandatit të tij si mbrojtës kryesor i të drejtave të njeriut në Evropë përmes ngritjes së perdes me të cilën mbulohet shpesh dhuna ndaj grave. Jam i kënaqur që Këshilli i Evropës e ka çuar në vend kërkesën e përsëritur e të vazhdueshme të Asamblesë Parlamentare se në Evropë duhet të ketë një instrument me forcë ligjore ku të vendosen standardet më të larta të mundshme për parandalimin, ndjekjen penale dhe mbrojtjen nga njëra prej formave më të rënda dhe më të përhapura të dhunës gjinore.



Pas dy vjet negociatash intensive, doli në dritë Konventa “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”. Tani kjo Konventë është hapur për nënshkrim dhe ratifikim. Besoj se detyra kryesore që kemi si parlamentarë që kanë të përbashkët angazhimin për të drejtat e njeriut, është të bëjmë çmos që kjo Konventë të hyjë sa më shpejt në fuqi.

Kemi shumë arsye për të cilat bëjmë mirë ta mbështesim Konventën: është i pari instrument i këtij lloji, që trajton në mënyrë specifike dhunën ndaj grave, që ka fuqi ligjore dhe që është e hapur për të gjitha vendet e botës; është i gjithanshëm, sepse përfshin masa në fushën e parandalimit të dhunës, mbrojtjes së viktimave, ndjekjes penale të autorëve të dhunës, si edhe në fushën e politikave të integruara; u kërkon shteteve të parashikojnë si vepra penale format kryesore të dhunës ndaj grave dhe të sigurojnë sanksione të mjaftueshme dhe të efektshme kundër tyre; është i pajisur me një mekanizëm të fortë dhe të pavarur monitorimi, ku do të marrin pjesë aktive parlamentarët e vendeve përkatëse.

Por, mbi çdo arsye, unë mendoj se duhet ta mbështesim këtë Konventë sepse jeta pa dhunë është e drejta e parë e njeriut. Dhuna ndaj grave i privon ato nga dinjiteti. I privon ato nga guximi për të kërkuar barazinë. Asnjë grua nuk do të mund t’i gëzojë të drejtat e njeriut për sa kohë është viktimë e dhunës.

Duhet ta këpusim këtë rreth vicioz.

Kjo Konventë është e nevojshme dhe duhej të ishte hartuar prej kohësh.

Të mos e mbështetësh këtë Konventë do të ishte pranim i dhunës.

Të mos e mbështetësh këtë Konventë do të ishte krim.

Të mos e mbështetësh këtë Konventë do të ishte një tjetër krim ndaj grave.

Mendes Bota
Raportues i Përgjithshëm për dhunën ndaj grave
Koordinator Politik i Rrjetit Parlamentar “Gra të lira prej dhunës”

Roli i parlamentarëve për të mbështetur Konventën “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe të dhunës në familje”

Parlamentarët kanë një rol për të luajtur në mbështetje të Konventës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje”.

Si legjislatorë dhe miratues të politikave, parlamentarët mund ta çojnë përpara procesin që do të sjellë nënshkrimin dhe ratifikimin e Konventës. Gjithashtu, ata do të përfshihen drejtpërdrejt në ratifikimin e Konventës. Mes veprimtarive që mund të ndërmarrin, dhe është mirë të ndërmarrin, mund të përmendim:

- ▶ t’u kërkojnë llogari qeverive sa i takon mbështetjes për Konventën;
- ▶ t’u kërkojnë qeverive të tyre informacion lidhur me fazën e arritur në procesin e nënshkrimit dhe ratifikimit;
- ▶ të organizojnë debate për Konventën në nivel kombëtar, sidomos brenda parlamenteve;
- ▶ të sigurohen që të gjitha dokumentet mbështetëse të jenë në qendrën e dokumentacionit të parlamentit;
- ▶ të ndërmarrin dhe të mbështetin nisma për të rritur njohuritë për Konventën tek organizmat shtetërore dhe shoqëria civile;
- ▶ të ndërmarrin nismën për një peticion publik në mbështetje të Konventës;
- ▶ të sigurohen që Konventa të përkthehet në gjuhët përkatëse.

Pavarësisht Konventës së Stambollit, parlamentarët mund të japin një kontribut madhor për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave, sidomos:

- ▶ duke ndërmarrë nisma ligjore në fushën e dhunës ndaj grave, për të bërë të mundur që ky legjislacion të pasqyrojë standardet më të larta ndërkombëtare;
- ▶ duke kërkuar kryerjen në nivel kombëtar të mbledhjes sistematike të të dhënave për dhunën ndaj grave;
- ▶ duke u siguruar që për ofruesit e shërbimeve për viktimat e dhunës të caktohen burime të mjaftueshme.

Në fund, si drejtues të opinionit, parlamentarët kanë mundësinë e privilegjuar për të kontribuar në ndryshimin e mendësive. Për këtë qëllim:

- ▶ ata duhet të mbajnë qëndrime të forta publike duke dënuar dhe mos pranuar dhunën ndaj grave, edhe në media;
- ▶ të bëjnë lobim pranë partive të tyre politike për ta përfshirë zhdukjen e dhunës ndaj grave në programet e tyre politike;
- ▶ të përmendin nevojën për ta zhdukur dhunën ndaj grave në çdo fjalim publik;
- ▶ të organizojnë veprimtari ndërgjegjësimi për dhunën ndaj grave, duke përfshirë edhe drejtues të tjerë të opinionit publik, si gazetarë, shkrimtarë, personalitete të mediave.

Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe të dhunës në familje” (CETS nr. 210, “Konventa e Stambollit”)

Përse duhet një konventë

Fakte dhe shifra

Një numër i konsiderueshëm grash dhe vajzash në të gjitha vendet e Këshillit të Evropës pësojnë dhunë çdo ditë. Gratë dhe vajzat janë shpesh objekt i formave të rënda të dhunës, si dhuna në familje, dhuna seksuale, përdhunimi, martesë me detyrim dhe gjymtimi i organeve gjenitale. Dhuna mund të jetë edhe psikologjike dhe të jetë në formën e dhunës verbale, kritikave, izolimit, kërcënimeve, ngacmimit dhe përndjekjes. Fakti se nuk është fizike nuk e bën këtë lloj dhune më pak të dëmshme apo më pak të rëndë. Autorët dhe viktimat janë nga të gjitha fushat e jetës. Nuk vuajnë vetëm personat që pësojnë dhunë, por traumë pësojnë edhe fëmijët që bëhen dëshmitarë të dhunës.

Dhuna ndaj grave prek gra të të gjitha moshave dhe niveleve, edhe pse ka disa grupe të caktuara që ndodhen në pozita veçanërisht të pambrojtura. Dhuna ka hedhur rrënjë të thella në pabarazinë mes grave dhe burrave në shoqëri dhe ushqehet më tej nga kultura e mungesës së tolerancës dhe e mospranimit të së vërtetës. Shkak dhe pasojë e saj janë marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit mes grave dhe burrave në shoqëri. Diskriminimi dhe qëndrimet ndaj grave që vijnë nga pabarazia e pushtetit i pengojnë gratë të largohen nga situatat e dhunshme. Dhuna që pësojnë nuk merret

gjithmonë seriozisht nga shoqëria ose nga autoritetet, duke i bërë ato pre e dhunimit të mëtejshëm, madje edhe e vrasjes.

Fatkeqësisht, dhuna ndaj grave shpesh konsiderohet një problem privat dhe shumë gra nuk e kanë nxitjen për ta kallëzuar ose pengohen ta bëjnë një gjë të tillë nga familjarët apo mjedisi shoqëror ku jetojnë. Nivelet e ulëta të kallëzimeve vijnë edhe nga mangësitë në hetimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin e këtyre veprave. Shumë çështje nuk arrijnë deri në gjykatë ose, edhe kur arrijnë atje, autorëve u jepet dënim minimal. Mungesa e ndjeshmërisë ndaj viktimave gjatë hetimit dhe gjatë procesit gjyqësor shpesh e riviktimizojnë gruan. Kjo i step gratë që ta kallëzojnë dhunën, sidomos edhe sepse, në mungesë të mbrojtjes së duhur, kallëzimi e rrit rrezikun që të pësojnë dhunë të mëtejshme.

Dhuna në familje është një vepër dhune që shkakton trauma të thella. Pjesa dërrmuese e viktimave janë gra dhe vajza. Hulumtimet kanë treguar se ekziston një lidhje midis dhunimit fizik të fëmijëve dhe dhunës në familje ndaj grave. Por, ka shumë pak punë kërkimore me rezultate të besueshme për format e tjera të dhunës në familje siç është dhuna ndaj të moshuarve apo dhuna ndaj burrave. Edhe pse disa burra mund të pësojnë dhunë në familje, shpeshësia dhe shkalla e dhunës është shumë më e vogël se dhuna ndaj grave, dhe gjithashtu burrat mund të pësojnë dhunë si përgjigje ndaj dhunës që kanë nisur ata vetë. Në shumicën e rasteve, burrat janë autorët e dhunës.

Kostoja financiare e dhunës ndaj grave është e lartë, e çmohet të jetë 34 miliard euro në vit për çdo shtet anëtar të Këshillit të Evropës, shumë e cila arrin deri në 555 euro për frymë.¹

Procesi që ka çuar në miratimin e Konventës

Prej viteve '90 të shekullit XX, Këshilli i Evropës i ka intensifikuar veprimtarinë për t'i luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave. Kulmi i këtij angazhimi erdhi në vitin 2002 me miratimin e Rekomandimit

1. www.coe.int/t/dg2/equality/DOMESTICVIOLENCECAMPAIGN/FAQ_en.asp#P59_4532

Rec (2002) 5 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për mbrojtjen e grave nga dhuna.²

Në vitin 2005, plani i veprimit i miratuar në fund të Samitit të Tretë të Krerëve të Shteteve dhe Qeverive të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës nisi një fushatë mbarëeuropiane për dhunën ndaj grave, duke përfshirë edhe dhunën në familje.³ Më pas u ngrit një grup i posaçëm pune për të mbështetur fushatën, për të vlerësuar ecurinë e shteteve anëtare dhe për të bërë rekomandime për veprimet e ardhshme. Nga viti 2006 deri në vitin 2008, në kuadër të fushatës së Këshillit të Evropës qeveritë, parlamentet dhe organet vendore e rajonale të Evropës u organizuan së bashku në fushatë.

Sipas vlerësimit që u ka bërë grupi i posaçëm i punës masave kombëtare të marra nga shtetet anëtare, doli se mbetej edhe shumë për të bërë. Me gjithë progresin e arritur, ishte e qartë se shpesh legjislacioni ekzistues nuk vihej në zbatim, shërbimet për viktimat qenë të pakta dhe me fonde të pamjaftueshme dhe kishte një pabarazi shumë të madhe mes shteteve anëtare sa i takon mbrojtjes. Në raportin përfundimtar të veprimtarisë së vitit 2008, grupi i posaçëm i punës rekomandonte miratimin e një instrumenti të Këshillit të Evropës në fushën e të drejtave të njeriut që të ishte i gjithanshëm e me fuqi ligjore , për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave.⁴

Në përgjigje të këtyre konstatimeve dhe rekomandimeve, në dhjetor 2008 Komiteti i Ministrave ngriti një komision të posaçëm shumëdisiplinor për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje, të cilit i ngarkoi detyrën e përgatitjes së një a më shumë instrumenteve me fuqi ligjore në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, kryesisht të përqendruar te masat e mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimave të kësaj dhune dhe masave të ndjekjes penale të autorëve.

2. <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=280915>

3. www.coe.int/t/dcr/summit/20050517_plan_action_en.asp

4. www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/Source/Final_Activity_Report.pdf

Në takimin e tij të parë komisioni i posaçëm shumëdisiplinor për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje mori vendim se zgjedhja e duhur do të ishte një konventë e vetme e gërshetuar me masa të parandalimit dhe luftimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje ndaj të gjithë anëtarëve të familjes. Konventa u hartua nga Komisioni i lartpërmendur gjatë nëntë mbledhjeve me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të qeverive dhe të grupeve të tjera të interesit.

Asambleja Parlamentare mori pjesë aktivisht në negociatat përmes Kryetarit të Komisionit të atëhershëm për Mundësitë e Barabarta për Gratë dhe Burrat. Projekt-teksti u finalizua në dhjetor 2010 dhe u miratua nga Komiteti i Ministrave më 7 prill 2011. Konventa u hap për nënshkrim në konferencën ministrore në Stamboll më 11 maj 2011. Ajo do të hyjë në fuqi pas 10 ratifikimeve prej të paktëve 8 shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

Vlera e shtuar e Konventës

Konventa e Stambollit është një instrument revolucionar. Është instrumenti i parë ndërkombëtar me fuqi ligjore, i hapur për çdo vend të botës, ku parashikohet një paketë e gjithanshme masash për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Konventa e njej dhunën ndaj grave si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si formë diskriminimi. Në të bëhet lidhja e qartë midis arritjes së barazisë mes grave dhe burrave dhe eliminimit të dhunës ndaj grave. Konventa kërkon parashikimin si vepër penale të veprave specifike si përndjekja, detyrimi për martesë, gjymtimi i organeve gjenitale të femrave, ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas dhe sterilizimi forcërisht.

Konventa trajton edhe qasjen e nevojshme për të trajtuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje duke u bërë thirrje të gjitha agjencive, shërbimeve dhe organizatave joqeveritare përkatëse të punojnë së bashku në mënyrë të bashkërenduar. Në të parashikohet një mekanizëm i fortë dhe i pavarur monitorimi dhe një rol specifik për parlamentarët në mbikëqyrjen e zbatimit të Konventës në

nivel kombëtar. Gjithashtu, i kërkohet Asamblesë Parlamentare të vrojtojë rregullisht zbatimin e një instrumenti të tillë.

Objektivat e manualit

Parlamentarët mund të luajnë një rol kyç në ndërgjegjësimin e publikut për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Në të njëjtën kohë, ata mund të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në kuadrin ligjor, duke propozuar e miratuar akte ligjore specifike për dhunën ndaj grave dhe duke mbikëqyrur zbatimin e efektshëm të tyre.

Ky manual përbën një instrument për nxitjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive të parlamentarëve në lidhje me Konventën e Stambollit dhe për t'i ndihmuar ata ta promovojnë këtë konventë. Manuali shpjegon dispozitat kryesore të Konventës duke dhënë edhe shembuj se si mund të pasqyrohen këto dispozita në legjislacionin dhe politikat kombëtare.

Në manual jepen shembuj të legjislacioneve dhe masave kombëtare që kanë miratuar shtetet anëtare të Këshillit të Evropës për të trajtuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Këta shembuj ilustrojnë llojet e akteve ligjore dhe të masave që mund të miratohen. Shembujt nuk përbëjnë një listë të plotë të të gjitha ligjeve të miratuara po të masave të marra nga shtetet anëtare.

Çfarë mbulon Konventa

Kapitulli i Konventës

Qëllimet

Konventa u jep palëve një kuadër gjithëpërfshirës politikash dhe masash mbështetur në përvojën më të mirë për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Qëllimet kryesore të saj janë:

- ▶ mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës, si dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

- ▶ kontributi ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, nxitja e barazisë midis burrave dhe grave dhe fuqizimi i grave;
- ▶ mbrojtja dhe ndihma për të gjitha viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
- ▶ nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar kundër këtyre formave të dhunës;
- ▶ ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe organet e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përjasjeje të integruar për të eliminuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.

Objekti

Konventa gjen zbatim mbi të gjitha format e dhunës ndaj grave, duke përfshirë dhunën në familje.

Gjithashtu, nxiten Palët ta shtrijnë zbatimin e Konventës mbi të gjitha viktimat e dhunës në familje, përfshirë edhe viktimat meshkuj, fëmijë dhe të moshuar.

Konventa gjen zbatim në kohë paqeje dhe në situata konflikti të armatosur.

Përkufizime

Përkufizimi i dhunës ndaj grave mbështetet në përkufizimet e parashikuara në Rekomandimin (2002)⁵ të Komitetit të Ministrave, në Rekomandimin e Përgjithshëm 19 të CEDAW-t⁵ dhe në nenin 1 të Deklaratës së OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave.⁶

- ▶ ***Dhuna ndaj grave*** përkufizohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave dhe përfshin të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike apo ekonomike për gratë, duke përfshirë

5. www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/recomm.htm

6. A/RES/48/104, 20 dhjetor 1993.

kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike, qoftë në atë private.

- ▶ **Dhuna në familje** nënkupton të gjitha llojet e dhunës si më lart, por që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi jeton apo ka jetuar ndonjëherë me viktimën. Kjo mbulon viktimat dhe autorët e të dyja gjinive dhe përfshin edhe dhunën ndaj fëmijëve dhe të moshuarve, si edhe dhunën mes partnerëve në marrëdhënie intime.
- ▶ **Gjinia/përkatësia gjinore** nënkupton rolet që u cakton shoqëria burrave dhe grave, si edhe sjelljet, veprimtaritë dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat.
- ▶ **dhuna gjinore ndaj grave** është dhuna që ka si shënjestër gratë pikërisht pse janë gra (siç është ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas, gjymtimi i organeve gjenitale të femrave) ose që prek gratë shumë më tepër sesa burrat (si dhuna seksuale, përdhunimi, përndjekja, ngacmimi seksual, dhuna në familje, detyrimi për martesë dhe sterilizimi forcërisht).
- ▶ **viktima** nënkupton viktimat e dhunës ndaj grave dhe viktimat e dhunës në familje.
- ▶ termi **“gra”** përfshin edhe vajzat nën moshën 18 vjeç.

Liria nga dhuna, barazia dhe mosdiskriminimi

Konventa promovon dhe mbron të drejtën për çdokënd për të jetuar i lirë nga dhuna dhe ndalon të gjitha format e diskriminimit të grave, që është një trajtim i ndryshëm pa një shkak objektiv e të arsyeshëm. Barazia mes grave dhe burrave si në ligj ashtu edhe në praktikë është shtylla qendrore për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave. Palëve u kërkohet të:

- ▶ përfshijnë parimin e barazisë midis grave dhe burrave në kushtetutat ose ligjet e tyre
- ▶ ndalojnë diskriminimin, veçanërisht nëpërmjet parashikimit të sanksioneve;

- ▶ shfuqizojnë ligjet dhe praktikat që diskriminojnë gratë.

Lista e shkaqeve të diskriminimit që jepet në Konventë (neni 4) mbështetet në nenin 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe në Protokollin nr. 12 të saj. Kjo listë është e hapur për t'u zgjatur më tej, dhe në të përfshihen gjinia, orientimi seksual, identiteti gjinor, mosha, gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar, gjendja civile, statusi i emigrantit ose refugjatit ose çdo status tjetër që lidhet drejtpërdrejt me Konventën. Duke vënë re se mund të dalë nevoja për masa të posaçme për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna, këto nuk konsiderohen diskriminim sipas Konventës.

Politikat e integruara dhe mbledhja e të dhënave

Kapitulli II i Konventës

Politikat gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara

Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë dukuri komplekse që kërkojnë marrjen e masave të gjithanshme nga shumë aktorë dhe agjenci. Përvoja ka treguar se rezultatet e suksesshme lidhen drejtpërdrejt me aktorë të tillë si policia, gjyqësori, shërbimet sociale, shëndetësia, OJQ-të e grave, agjencitë e mbrojtjes së fëmijëve dhe partnerë të tjerë, që punojnë nga afër e në bashkërendim me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, Konventa bën thirrje për:

- ▶ një paketë të gjithanshme masash legislative dhe politike të bashkërenduara në të gjithë sektorët;
- ▶ vendosjen e të drejtave të viktimës në qendër të të gjitha masave;
- ▶ përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës, duke përfshirë agjencitë shtetërore, OJQ-të dhe parlamentet kombëtare, rajonale dhe vendore, duke patur parasysh rolin e rëndësishëm të parlamentarëve dhe kompetencat e ndryshme ligjvënëse në Shtetet Palë me sistem federal.

Një bashkëpunim i tillë nuk mund t'i lihet rastësisë. Ky bashkëpunim kërkon protokolle dhe trajnim për të siguruar kuptim dhe qasje të përbashkëta. Një shembull se si mund të arrihet një bashkëpunim

dhe bashkërendim i tillë janë planet kombëtare të veprimit që i japin çdo agjencie një rol të veçantë dhe që përfshijnë edhe OJQ-të.

Në Mbretërinë e Bashkuar, janë përdorur Konferencat shumë-dikasteriale (shumëdisiplinore) për vlerësimin e rrezikut, për t'u dhënë mundësi të gjitha organeve lokale të mbliidhen rregullisht dhe të shkëmbejnë informacione për viktimat e dhunës në familje që ndodhen në rrezik të lartë (ato viktimat që janë në rrezik vrasjeje ose lëndimi të rëndë). Përmes përfshirjes së të gjitha institucioneve në këto konferenca, mund të hartohet në mbështetje të viktimës një plan i bashkërenduar duke patur parasysh rrezikun konkret të rastit. Mbi 250 grupime të tilla ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mbarë Anglinë, Uellsin dhe Irlandën e Veriut, për të trajtuar mbi 53 mijë raste në vit (për më shumë informacion: www.caada.org.uk). Në Austri dhe Gjermani, janë ngritur qendra të ndërhyrjes për dhunën në familje dhe dhunën seksuale për të bashkërenduar kundërpërgjigjen e të gjitha institucioneve përkatëse (qendrave të strehimit, forcave të rendit, prokurorisë, gjyqësorit, mbrojtjes së dëshmitarëve, mbrojtjes së fëmijëve) për rastet e dhunës në familje ose dhunës seksuale (për më shumë informacion për qendrën e ndërhyrjes në Vjenë shih www.interventionsstelle-wien.at ose për Qendrën e Ndërhyrjeve në Berlin www.big-berlin.info).

Organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile

OJQ-të dhe shoqëria civile luajnë një rol kyç në parandalimin dhe luftimin e dhunës. OJQ-të administrojnë shumicën e shërbimeve për viktimat e dhunës dhe të veprimtarive të ndërgjegjësimit por ato pengohen nga mungesa dhe pasiguria e fondeve. Konventa kërkon të sigurojë një mbështetje më të madhe politike dhe financiare për punën e tyre. Palëve u kërkohet të pranojnë, nxisin dhe mbështesin OJQ-të për t'u dhënë mundësi ta vazhdojnë punën e tyre sa më mirë, për të vendosur bashkëpunim mes organeve publike dhe OJQ-ve dhe për të siguruar fonde të mjaftueshme.

Mbledhja e të dhënave dhe puna kërkimore

Mbledhja e të dhënave është thelbësore për të kuptuar natyrën dhe përhapjen e dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje si dhe për të hartuar politika të mbështetura në faktet e provuara, për t'i dhënë përgjigje dhunës dhe për të vlerësuar si funksionojnë këto politika. Konventa u kërkon Palëve të mbledhin të dhëna statistikore në nivel kombëtar, për shembull të dhënat administrative të përpiluara nga shërbimet, OJQ-të dhe nga sektori i drejtësisë. Raportimi duhet të përfshijë hollësi specifike për viktimën dhe autorin, të tilla si gjinia, mosha dhe lloji i dhunës, marrëdhënia mes dhunuesit dhe-viktimës si dhe vendi ku është kryer vepra. Shtetet Palë kanë detyrimin të mbështesin edhe punë kërkimore për shkaqet dhe pasojat e dhunës dhe nxiten të kryejnë vrojtime mbi popullatën për të vlerësuar shkallën e përhapjes dhe shpeshtësinë e kësaj dukurie. Ky informacion duhet t'i vihet në dispozicion publikut dhe grupit të ekspertëve që monitorojnë Konventën.

Në Spanjë, ligji organik i vitit 2003 për dhunën gjinore parashikoi ngritjen e një observatori shtetëror për dhunën ndaj grave, i cili mbledh të dhëna dhe ofron këshillë të specializuar për çështjet e dhunës gjinore (neni 30). Ky është një organ kolegjal, pranë Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, i cili ofron këshilla dhe analiza për çështjet e dhunës gjinore, merret me bashkëpunimin institucional, përgatitjen e raporteve dhe studimeve dhe paraqet propozime për ndërmarrjen e veprimeve në këtë fushë. Ai përfshin në funksionimin e tij edhe komunitetet autonome, autoritetet vendore, aktorët shoqërorë, shoqatat e konsumatorëve dhe përdoruesve dhe organizatat e grave me shtrirje në të gjithë vendin, si edhe organizatat më përfaqësuese të punëdhënësve dhe sindikatave.

Parandalimi

Kapitulli III i Konventës

Qëndrimet, paragjykimet, stereotipat gjinorë dhe zakonet e traditat e shtrembëruara gjinore ndikojnë në modelet e sjelljes që çojnë në vijimësinë e dhunës. Për të parandaluar të gjitha format e dhunës ndaj

grave dhe të dhunës në familje, Konventa u kërkon Palëve të miratojnë një varg masash të cilat duhen zbatuar në nivel kombëtar, të cilat:

- ▶ nxisin ndryshime të qëndrimeve dhe sjelljeve;
- ▶ marrin në konsideratë nevojat e personave të pambrojtur, duke vendosur në qendër të drejtat e tyre të njeriut;
- ▶ i nxisin të gjithë, sidomos burrat dhe djemtë, ta parandalojnë dhunën;
- ▶ sigurojnë që kultura, zakonet apo feja të mos përdoren si justifikim për dhunën;
- ▶ nxisin programe dhe veprimtari që fuqizojnë gratë.
- ▶ Në masat e parandalimit përfshihen:
- ▶ **Rritja e ndërgjegjësimit:** Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe organizimi i fushatave kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është thelbësore. Këto nisma ndihmojnë në informimin e publikut dhe u japin mundësi njerëzve të njohin format e ndryshme të dhunës dhe të ngrenë zërin kundër tyre. Po aq e rëndësishme është edhe përhapja e informacioneve që u japin mundësi viktimave ta dinë ku mund të gjejnë ndihmë dhe çfarë mbështetje ka në dispozicion të tyre, siç është publikimi i numrit telefonik kombëtar të ndihmës për viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave.

Në vitin 2004, në **Turqi**, gazeta me tirazhin më të madh "Hyrjet" nisi një fushatë kundër dhunës në familje. Kjo fushatë ishte një shembull unik i angazhimit të një institucioni mediatik privat në përpjekjen për ndryshimin e qëndrimeve dhe për rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë në lidhje me dhunën në familje. Fushata shërbeu si katalizator mbështetjeje dhe bashkëpunimi nga autoritetet vendore, politikanët, udhëheqësit fetarë, udhëheqësit e opinionit dhe OJQ-të e grave.

Nga viti 2006 deri në vitin 2008, **Këshilli i Evropës** organizoi një fushatë në mbarë Europën kundër dhunës në familje ndaj grave. Rreth 25 shtete anëtare e shndërruan këtë fushatë në një fushatë kombëtare për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për dhunën në familje.

Në vitin 2008, Sekretari i Përgjithshëm i **OKB-së** nisi një fushatë shtatëvjeçare “Bashkohuni për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave” për të mobilizuar mbështetje politike dhe financiare për këtë objektiv.

- ▶ **Edukimi:** Qëndrimet dhe sjelljet formohen qysh në moshë të vogël, prandaj është e rëndësishme që fëmijëve t’u mësohet se çfarë është barazia dhe respekti i ndërsjellë në një marrëdhënie. Palët nxiten të përfshijnë materiale mësimore mbi çështje të barazisë në të gjitha nivelet e programeve shkollore dhe t’i promovojnë këto parime në mjediset informale arsimore, si dhe në mjedise sportive dhe në qendrat komunitare.

Zvicra ka miratuar një lëndë që të përdoret në shkollat shtetërore për të trajtuar dhunën në familje, dhunën seksuale dhe dhunën mes të rinjve. **UNICEF** ka filluar një program arsimor të gjithanshëm të quajtur “Shkolla të mbrojtura dhe mbrojtëse”, duke përfshirë edhe një fushatë madhore për ta ndaluar dhunën mes fëmijëve. Qëllimi i fushatës është të sigurojë një mjedis të parrezikshëm për të gjithë fëmijët në shkolla fillore dhe të mesme. Në **Kroaci**, kjo fushatë është futur në më se 400 shkolla.

- ▶ **Trajnimi i profesionistëve:** Trajnimi i të gjithë profesionistëve përkatës mbi parandalimin dhe zbulimin e dhunës, barazinë, nevojat e të mbijetuarve, parandalimin e riviktimizimit dhe nxitjen e bashkëpunimit midis institucioneve.

Në **Danimarkë**, dhuna në familje është integruar në programin shkollor të studentëve të mjekësisë, infermierisë dhe shëndetit publik. Ajo zhvillohet si lëndë edhe në programet e specializimit për gjinekologji, patologji dhe psikiatri. Në **Mbretërinë e Bashkuar**, ka programe të veçanta trajnimi për gjyqtarët që merren me rastet e dhunës në familje. Ndjekja e këtyre kurseve është kriter për t’u bërë gjyqtar i specializuar për dhunën në familje. Në **Spanjë**, ngritja e gjykatave të

specializuara për çështjet e dhunës në familje ka krijuar mundësinë për të ofruar trajnim specifik për gjyqtarët dhe prokurorët.

- ▶ **Ndërhyrja parandaluese dhe programet e trajtimit** Konventa u kërkon Palëve të krijojnë ose mbështetin programe trajtimi për autorët e dhunës në familje dhe të krimeve seksuale për t'i mësuar të përdorin një sjellje jo të dhunshme, të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre dhe të shqyrtojnë qëndrimet e tyre kundrejt grave. Gjatë ndërtimit të programeve të trajtimit, kërkohet që siguria, mbështetja dhe të drejtat e viktimave të jenë shqetësim parësor dhe që këto programe të funksionojnë në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet mbështetëse të specialistëve për viktimat.

Në **Mbretërinë e Bashkuar**, OJQ-ja "Respect" ka hartuar standarde akreditimi për programet e parandalimit të dhunës në familje dhe për shërbimet e mbështetjes së integruar që punojnë me meshkujt që ushtrojnë dhunë në familje. Projekti **BE-Daphne** "Puna me autorët e dhunës në familje në Europë" ka hartuar standarde për programet e rehabilitimit të dhunuesve. Në **Gjermani**, OJQ-ja "Münchener Informationszentrum für Männer e.V." (Qendra e informacionit për burrat e Mynihut) ofron kurse për mbajtjen nën kontroll të zemërimit, programe për burrat agresivë dhe për meshkujt që kanë kryer krime seksuale, si edhe këshillim për çështjet e kujdestarisë për prindërit që duan të zgjidhin martesën për shkak të dhunës në familje.

Mbrojtja dhe mbështetja

Kapitulli IV i Konventës

Ofrimi i mbrojtjes dhe mbështetjes më të mirë të mundshme për viktimat, është thelbësor për parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe për të ndihmuar në rimëkëmbjen fizike, psikologjike dhe shoqërore të viktimave. Konventa përfshin një varg masash mbrojtëse, siç janë:

- ▶ marrja e urdhrave të menjëhershme ndaluese për t'i larguar autorët e dhunës nga banesa e familjes dhe urdhrat kufizues ose të mbrojtjes;
- ▶ informimi i viktimave të dhunës për të drejtat e tyre dhe që të dinë ku dhe si të kërkojnë ndihmë;
- ▶ ofrimi i shërbimeve të specializuara të mbështetjes;
- ▶ nxitja e kallëzimit të dhunës nga dëshmitarët dhe profesionistët;
- ▶ mbrojtja dhe mbështetja e fëmijëve që janë të pranishëm në aktet e dhunës.

Shërbimet mbështetëse të specializuara

Me shumë rëndësi për mbështetjen e grave viktimave të dhunës janë shërbimet mbështetëse të specializuara. Këto shërbime ofrojnë një qasje me ndjeshmëri gjinore e cila është përshtatur për të përmbushur nevojat e viktimave, shumë prej të cilave pësojnë dhunë të përsëritur dhe janë të traumatizuara. Grupe të veçanta të grave kanë nevoja të veçanta, siç janë të rejat, gratë migruese dhe gratë me aftësi të kufizuara. Nevojat për mbështetje ndryshojnë në varësi të llojit të dhunës së ushtruar dhe të nevojave për shërbime specifike siç janë qendrat për viktimat e përdhunimit dhe dhunës seksuale apo strehëzat për gratë. Disa gra kanë nevoja komplekse të cilat duan gjithashtu mbështetje të specializuar. Shërbimet e specializuara:

- ▶ duhet të jenë shërbime të menjëhershme, afatshkurtra dhe afatgjata;
- ▶ duhet të kenë shpërndarje në të gjithë vendin;
- ▶ duhet të jenë të arritshme për çdo viktimë që i nënshtrohet një akti dhune dhe fëmijëve të saj (dhe në një gjuhë të cilën e kuptojnë);
- ▶ duhet të kenë staf me zotësi dhe burime dhe fonde të mjaftueshme;
- ▶ duhet të jenë në gjendje t'i fuqizojnë viktimat.

Bashkia e Brukselit ka krijuar një shërbim të posaçëm të quajtur “Zyra për asistencën policore për viktimat”, e cila mirëpret viktimat, të afërmit e tyre dhe dëshmitarët e dhunës, duke ofruar në të njëjtën kohë këshillim dhe mbështetje për punonjësit e policisë. Stafit i kësaj zyre përbëhet nga psikologë

dhe kriminalistë. Në **Suedi**, Qendra Kombëtare për Gratë e Rrahura dhe të Përdhunuara ofron trajnim dhe orientim praktik për stafin shëndetësor dhe mjekësor, në fushën e dhunës seksuale dhe shërben si qendër burimore kombëtare e cila ofron informacion të specializuar lidhur me këtë temë.

Mbështetja për viktimat e dhunës seksuale

Viktimat e dhunës seksuale, duke përfshirë edhe viktimat e përdhunimit, kanë nevojë për kujdes të menjëhershëm mjekësor, vizita mjeko-ligjore, mbështetje për kapërcimin e traumës dhe këshillim psikologjik afatgjatë të ofruar nga një staf i trajnuar mirë dhe i specializuar. Kjo kërkon ngritjen e një numri të mjaftueshëm të qendrash referimi për dhunën seksuale, të cilat mund të shfrytëzohen lehtësisht nga të mbijetuarat. Ekipi i posaçëm i Këshillit të Europës për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje rekomandon një qendër për çdo 200 mijë banorë.

Prej vitit 1980, **Mbretëria e Bashkuar** ka ngritur qendra (referimi) për dhunën seksuale, të cilat bëjnë përpjekje për të siguruar reagim cilësor përmes vizitave mjeko-ligjore dhe këshillim afatshkurtër për viktimat e dhunës seksuale. **Norvegjia** ka ngritur qendra shërbimi për viktimat e përdhunimit dhe të dhunës seksuale në çdo qark. Këto janë të lidhura me klinikat ndërbashkiake të urgjencës. **Suedia** ka ngritur një Qendër Kombëtare për Gratë e Rrahura dhe të Përdhunuara ku bëhen vizitat mjekësore dhe ofrohet trajtim dhe mbështetje për viktimat.

Mbrojtja dhe mbështetja për fëmijë që janë dëshmitarë të dhunës

Fëmijët e familjeve ku dhuna është e pranishme zakonisht janë në dijeni të dhunës dhe mund të jenë edhe vetë objekt i keqtrajtimit, dhe të dyja këto shkaktojnë një dëmtim të konsiderueshëm. Shërbimet që mbështesin viktimat e dhunës ndaj grave dhe viktimat e dhunës në familje duhet të marrin në konsideratë nevojat e fëmijëve që

bëhen dëshmitarë të dhunës dhe të ofrojnë këshillim psiko-social të përshtatur sipas nevojave të tyre. Çdo mbështetje e ofruar duhet të jetë interesin më të lartë të fëmijës.

Plani i Veprimit i **Suedisë** "Për dhunën ndaj grave" mbështetet tek Konventa e OKB-së për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, për të theksuar faktin se të drejtën e mbrojtjes e kanë edhe fëmijët që janë qoftë edhe "vetëm" dëshmitarë të dhunës ndaj personave të rritur pranë tyre.

Raportimi nga profesionistët

Shumica e rasteve të dhunës ndaj grave mbeten të pakallëzuara. Shpesh dhuna kryhet pas dyerve të mbyllura dhe viktimat e vuajnë në heshtje atë. Kjo është një pengesë madhore për mbrojtjen e viktimave, parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe ndjekjen ligjore të autorëve të dhunës. Profesionistët që punojnë me viktimat, siç janë mjekët, psikologët dhe punonjësit socialë shpesh janë në dijeni të ekzistencës së dhunës dhe janë të shqetësuar se kjo dhunë mund të përsëritet, mirëpo rregullat profesionale të ruajtjes së fshehtësisë së informacionit i pengojnë ta kallëzojnë dhunën. Konventa parashikon mundësinë e moszbatimit të rregullave të konfidencialitetit për t'i lejuar profesionistët t'i kallëzojnë rastet e rënda të dhunës kur kanë arsye për të besuar se kjo dhunë ka ndodhur dhe do të ndodhë përsëri.

Në **Spanjë**, ligji për urdhrat gjyqësorë për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje e vendos detyrimin mbi institucionet dhe organet publike dhe private të shërbimeve sociale që vijnë në dijeni të rasteve të dhunës në familje që t'ia kallëzojnë këto raste magjistratit ose prokurorit në shërbim, me qëllim çeljen e procedurës për lëshimin e një urdhri mbrojtjeje.

Dispozitat materiale

Kapitulli V i Konventës

Konventa prezanton një varg masash të civile dhe penale për të mbushur shumë nga boshllëqet ekzistuese në legjislacion që hasin

viktimat e formave të ndryshme të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje kur i drejtohen organeve të drejtësisë. Këto boshllëqe shkojnë nga mungesa e skemave të kompensimit dhe çështjet e lidhura me të drejtat e kujdestarisë së fëmijëve deri tek fakti se mjaft forma të sjelljeve të dhunshme nuk konsiderohen krim në shumë shtete anëtare.

Paditë dhe mjetet ligjore civile

Objektivi i kësaj dispozite është të parashikojë mjetet ligjore që u japin mundësi gjykatave t'i japin fund një sjelljeje të caktuar dhe u japin mundësi viktimave të paraqesin kërkesë për urdhra të tillë gjyqësorë si urdhër-bllokimi, urdhër ndalimi, urdhër kufizimi apo urdhër kundër ngacmimit. Këto urdhra përbëjnë masa të rëndësishme mbrojtëse, duke qenë se, për shembull, nuk e lejojnë dhunuesin t'u afrohet viktimave në shtëpi dhe në zonën përreth saj. Në rastet e dhunës në familje, këto urdhra mund t'i ofrojnë viktimës një mbrojtje më afatgjatë, që nuk mund të jepet me urdhrat e menjëhershme të mbrojtjes.

Shteti është përgjegjës për mbrojtjen e grave nga të gjitha format e dhunës dhe nga dhuna në familje. Është përgjegjësi e shtetit të sigurojë që autoritetet shtetërore t'i parandalojnë, hetojnë dhe ndëshkojnë plotësisht aktet e dhunës. Nëse autoritetet nuk i mbështesin dhe mbrojnë plotësisht viktimat, atëherë kundër këtij mosveprimi duhet parashikuar mundësia për masa ligjore civile.

Në çështjen gjyqësore "**Bevacqua dhe S. kundër Bullgarisë**, "pala paditëse pretendonte se ishte rrahur rregullisht nga bashkëshorti, e kishte lënë bashkëshortin dhe kishte çelur procesin e zgjidhjes së martesës, duke marrë me vete edhe djalin e tyre trevjeçar. Mirëpo, sipas saj, bashkëshorti kishte vazhduar ta rrihte. Ajo kishte qëndruar katër ditë në një strehëz për gra të dhunuara, së bashku me të birin, por, sipas saj, e kishin kërcënuar se mund të kalonte në ndjekje penale për rrëmbim të fëmijës, pasi gjykata kishte vendosur për kujdestari të përbashkët të fëmijës, vendim i cili, sipas saj, nuk

respektohej nga bashkëshorti. Ngritja e padisë ndaj bashkëshortit për dhunë në familje provokoi dhunë të mëtejshme ndaj paditëses. Edhe kërkesa e saj për një vendim të ndërmjetëm nga gjykata që t'ia linte vetëm asaj fëmijën për rritje dhe edukim nuk u trajtuan me përparësi dhe ajo arriti të marrë kujdestarinë e fëmijës vetëm pasi përfundoi procesi i zgjidhjes së martesës, pas më shumë se një viti. Edhe pas një viti, ajo vazhdonte të rrihej nga ish-bashkëshorti dhe kur ajo bëri kallëzim në prokurori dhe kërkoi ndjekje penale për dhunuesin, kërkesa e saj nuk u pranua për arsye se ishte “çështje private” që kërkonte ngritjen e akuzës së të dëmtuarës drejtpërdrejt në gjykatë, pa përfshirjen e organit të prokurorisë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi se ishte shkelur neni 8 (e drejta e respektimit të jetës familjare), duke qenë se autoritetet bullgare nuk kishin marrë masat e nevojshme për të ndëshkuar dhe mbajtur nën kontroll dhunuesin. Gjykata theksoi gjithashtu se trajtimi i kësaj mosmarrëveshjeje si “çështje private” binte në kundërshtim me detyrimin që kishin autoritetet për të mbrojtur jetën familjare të palës paditëse.

Kompensimi

Në Konventë parashikohet e drejta për kompensimin e dëmeve të pësuar si pasojë e shkeljeve që mbulon Konventa. Kryesisht është autori i dhunës ai që mban përgjegjësi për kthim dhe dëmshpërblimin e tyre, ndërsa Palët kanë detyrim plotësues për ta bërë këtë gjë në ato raste kur viktimat ka pësuar dëme të rënda trupore ose cenim të shëndetit.

Ky detyrim plotësues i shtetit për të kompensuar nuk pengon Palët që të kërkojnë kthim për kompensimin e dhënë nga autori i veprës penale, për sa kohë që i kushtohet rëndësia e duhur sigurisë së viktimës.

Në vitin 1976, **Gjermania** miratoi ligjin për dëmshpërblimin e viktimave të krimeve të dhunës, i cili u garantonte viktimave

të krimeve të tilla të dhunshme se përdhunimi, sulmi seksual, sulmi fizik dhe vrasja me paramendim, kompensim në lidhje me pasojat e dhunës që pësojnë (kostot mjekësore, këshillim psikologjik, paaftësi për punë, etj.)

Kujdestaria, të drejtat e vizitave dhe siguria

Dhunuesit e përdorin mundësinë e vizitave tek fëmijët për ta sulmuar përsëri viktimën dhe nga kjo kanë ardhur si pasojë akte të rënda dhune, madje edhe vrasje. Të gjitha masat për mbrojtjen e viktimave duhet të jenë në përputhje me njëra-tjetrën. Për shembull, nëse dhunuesve u ndalohet t'i afrohen viktimës përmes një vendimi të marrë nga seksioni civil i gjykatës, seksioni familjar i gjykatës duhet të bëjë të njëjtën gjë. Kështu, Konventa siguron që në përcaktimin e kujdestarisë dhe të drejtës së vizitës së fëmijëve, të merren në konsideratë incidentet e dhunës, në interesin më të lartë të fëmijës.

Format e dhunës

Konventa u kërkon Palëve të parashikojnë si vepër penale një gamë të gjerë formash të dhunës, ku përfshihen:

- ▶ **Dhuna psikologjike** frikësimi i qëllimshëm, ngacmimi ose kërcënimi i dikujt gjatë një periudhe kohe, duke i shkaktuar traumë këtij personi. Në marrëdhëniet intime, dhuna psikologjike shpesh mund të pasohet me dhunë fizike dhe seksuale.

Në **Francë**, në vitin 2010 u fut në Kodin Penal vepra penale e dhunës psikologjike. Ky krim mund të dënohet me sanksione të rënda, që shkojnë nga 75.000 euro gjobë në tre vjet burgim.

- ▶ **Përndjekja:** kërcënimi i dikujt në mënyrë të përsëritur, duke e ndjekur, duke e angazhuar në komunikim të padëshiruar ose duke e informuar se po vrojtohet enkas, duke i shkaktuar kështu frikë për sigurinë. Kjo mund të përfshijë dëmtimin e pasurisë, vënien e familjes, miqve ose kafshëve shtëpiake të viktimës në objektiv, ose përhapjen e informacioneve të rreme në internet.

Edhe pse, në parim dhuna psikologjike dhe përndjekja duhen parashikuar si vepra penale, Konventa lejon njëfarë rezerve për t'u ofruar lirshmëri Palëve, sistemet juridike të të cilave parashikojnë sanksione jopenale për këto lloje sjelljesh. Megjithatë, sanksionet jopenale duhen zbatuar dhe duhet të jenë të mjaftueshme për t'i dënuar autorët e këtyre akteve dhe për t'i frenuar që të mos e kryejnë këtë sjellje në të ardhmen.

Në **Itali**, përndjekja u fut si vepër penale në vitin 2009. Ajo dënohet me burgim, nga gjashtë muaj deri në katër vjet. Nëse autori i aktit është ish-bashkëshort ose dikush që ka qenë në marrëdhënie intime me viktimën, dënimi mund të rritet deri në gjashtë vjet burgim. Kjo vlen edhe nëse viktima është i/e mitur.

- ▶ **Dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin:** çdo akt seksual i kryer qëllimisht ndaj dikujt pa pëlqimin e këtij të fundit. Këtu përfshihet depërtimi në çdo pjesë të trupit të një personi tjetër me ndonjë pjesë trupore të autorit të aktit ose me objekte. Veprat penale të dhunës seksuale shpesh kalojnë pa u ndëshkuar, sepse shpesh të tjerët nuk u besojnë viktimave nëse ato nuk mund të dëshmojnë se janë përpjekur ta kundërshtojnë dhunën. Për ta trajtuar këtë boshllëk, Konventa kërkon që të merren në çdo rast në konsideratë rrethanat në të cilat është kryer akti, kur vlerësohet nëse ka pasur apo jo pëlqim nga ana e viktimës, pavarësisht nëse viktima ka bërë apo jo rezistencë fizike. Me këtë dispozitë parashikohet si vepër penale edhe përdhunimi brenda lidhjes martesore, brenda lidhjes mes partnerëve apo ndërmjet ish-bashkëshortëve apo ish-partnerëve.

Deklarata e OKB-së për Eliminimin e Dhunës Ndaj Grave, e miratuar nga **Asambleja e Përgjithshme** e OKB-së në vitin 1993, e përmend shprehimisht përdhunimin martesor si njëren prej formave të dhunës ndaj grave.

- ▶ **Ngacmimi seksual:** çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, joverbale ose fizike e një natyre seksuale, që ka për qëllim ose pasojë

shkeljen e dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijon një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose fyes. Edhe këtu Konventa u lejon Palëve të zgjedhin një sanksion jo-penal për këtë lloj sjelljeje, që do të thotë një sanksion civil ose administrativ.

- ▶ **Detyrimi për martesë:** përdorimi i qëllimshëm i kërcënimeve fizike ose psikologjike për ta detyruar një të rritur ose një fëmijë për të lidhur martesë, ose çarja e një të rrituri ose fëmije në një vend tjetër me qëllim për ta detyruar të lidhë martesë.

Në **Mbretërinë e Bashkuar**, fushata e zhvilluar nga OJQ-ja "Southall Black Sisters" solli si rezultat nxjerrjen e e udhëzimeve për punonjësit e policë lidhur me trajtimin e detyrimit për martesë e detyruar dhe përmirësoi reagimin e Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar në rastet kur shtetasit britanike shtrëngoheshin të lidhnin martesë jashtë territorit të Mbretërisë së Bashkuar. Kodi Penal i **Bullgarisë** e parashikon si vepër penale detyrimin e një personi për të lidhur martesë, si edhe rrëmbimin e një gruaje me qëllim për ta detyruar të lidhë martesë.

- ▶ **Gjymtimi i organeve gjenitale femërore:** përfshin të gjitha procedurat që qëllimisht ndryshojnë ose dëmtojnë organet gjenitale femërore për arsye jo-mjekësore. Kjo shkakton dëm të përhershëm të pariparueshëm dhe zakonisht kryhet pa pëlqimin e viktimave. Sanksione penale parashikohen në Konventë edhe për këdo që ndihmon autorët në kryerjen e gjymtimit gjeneral të femrave.

Në **Austri**, deri në vitin 2001, shkaktimi i dëmtimit trupor nuk ishte i dënueshëm nëse bëhej me pëlqimin e palës së dëmtuar. Për pasojë, praktika e gjymtimit të organeve gjenitale femërore nuk ishte e dënueshme nëse pëlqimin e jepte prindi ose kujdestari ligjor i vajzës. Me një ndryshim të kodit penal, Austria siguroi që të mos lejohet dhënia e pëlqimit për "një gjymtim ose plagosje të organeve gjenitale që ka për qëllim shkaktimin e një kufizimi të përhershëm të ndjeshmërisë seksuale".

- ▶ **Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas dhe sterilizimi i detyruar:** përfshin kryerjen e ndërprerjes së shtatzënisë së një gruaje pa pëlqimin e saj paraprak dhe të bazuar në informim; dhe kryerja e një operacioni kirurgjikal që ka për qëllim ose pasojë e ndërprerjes së aftësisë riprodhuese të një gruaje, pa pëlqimin e saj paraprak ose kuptimin e procedurës.

Dhënia e ndihmës ose bashkëpunimi dhe tentativa

Çdokush që qëllimisht asiston, nxit ose mbështet dikë për kryerjen e krimeve të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale, përndjekjes, detyrimit për martesë, gjymtimit të organeve gjenitale femërore apo ndërprerjes së shtatzënisë pa pëlqimin e gruas dhe sterilizimit të detyruar është po ashtu fajtor për veprën penale sipas Konventës. Kjo dispozitë mbulon edhe veprat sipas legjislacionit penal, administrativ dhe civil. Gjithashtu, përbën veper edhe tentativa e qëllimshme për të kryer dhunë fizike ose seksuale, detyrim për martesë, gjymtim të organeve gjenitale femërore apo ndërprerje të shtatzënisë pa pëlqimin e gruas dhe sterilizim të detyruar.

Justifikime të papranueshme për kryerjen e krimeve, duke përfshirë krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit "nder"

Për të trajtuar shkaqet që qëndrojnë në rrënjët e dhunës ndaj grave dhe sjelljet që e mbajnë të gjallë dhunën, Konventa mishëron parimin se sjellja kriminale është e papranueshme në asnjë rrethanë. Kultura, feja, tradita ose arsyet e tjera personale për sjelljen kriminale nuk mund të pranohen si justifikim për të shfajësuar dhunën ndaj grave apo e dhunës në familje dhe këto shkaqe nuk duhen përdorur nga gjyqësori në arsyetimin për interpretimin e ligjit. Aktet e dhunës për këto shkaqe shpesh kryhen nga fëmijë që janë nën moshën për përgjegjësi penale, të cilët veprojnë nën nxitjen e një anëtarit të rritur të familjes apo komunitetit. Për të trajtuar këtë boshllëk, Palët duhet të parashikojnë përgjegjësinë penale të çdo personi që nxit këto krime.

Juridiksioni

Zbatohen parime juridiksioni të ngjashme me ato të Konventave të tjera të Këshillit të Evropës, për të siguruar që:

- ▶ t'u kërkohet Palëve të ndëshkojnë autorët e veprave penale të kryera në territorin e tyre, në bordin e një anijeje që ngre flamurin e tyre, në bordin e një avioni të regjistruar sipas ligjeve të tyre; nga një prej shtetasve të tyre ose nga një person i cili ka vendqëndrimin e tij ose të saj të zakonshëm në territorin e tyre.
- ▶ të nxiten Palët për të ndjekur penalisht dhe për të gjykuar çdo veprë penale të kryer ndaj një prej shtetasve të tyre ose një personi që ka vendqëndrimin e tij ose të saj të zakonshëm në territorin e tyre kur këta ndodhen jashtë vendit..
- ▶ çdo shtetas që kryen vepra të dhunës seksuale, detyrimit për martesë, gjymtimit të organeve gjenitale femërore, ndërprerjes së shtatzënisë pa pëlqimin e gruas dhe sterilizimit të detyruar të ndëshkohet nga Palët edhe kur vepra është kryer jashtë territorit të tyre. Kjo dispozitë gjën zbatim, pavarësisht nëse këto vepra parashikohen apo jo si vepra penale në vendin ku janë kryer apo nëse është bërë apo jo ankesë nga viktimja apo nëse është hetuar apo jo nga autoritetet e atij vendi.
- ▶ autori i krimit që jeton në territorin e tyre të ndiqet penalisht nga Palët nëse nuk është ekstraduar për në vendin ku është kryer krimi ose prej nga vjen viktimja.

Sanksionet dhe masat

Palëve u kërkohet të sigurohen që sanksionet e vendosura për veprat penale të përcaktuara nga Konventa të marrin parasysh rëndësinë e veprës. Sanksionet duhet të jenë "efektive, në përputhje me rëndësinë e veprës dhe frenuese" dhe mund të përfshijnë dënime me heqje lirie ose heqjen e të drejtave prindërore, nëse interesi më i lartë i fëmijës, që mund të përfshijë sigurinë e viktimës, nuk mund të garantohet në një mënyrë tjetër.

Rrethanat rënduese

Konventa parashikon dënime më të rënda në disa rrethana të caktuara, për shembull nëse vepra është kryer ndaj një anëtari të afërt të familjes, në mënyrë të përsëritur, ndaj një personi në pozita veçanërisht të pambrojtura, ndaj një fëmije ose në prani të një fëmije, kur vepra është kryer nga disa persona, është kryer me dhunë të skajshme, me përdorimin ose nën kërcënimin e armës, shkakton dëm të rëndë tek viktimat dhe kur autori është dënuar edhe më parë për një vepër penale të ngjashme.

Në **Spanjë**, pas miratimit të ligjit organik për dhunën gjinore, u ndryshua neni 148 i Kodit Penal, për të rritur dënimin nëse veprat e dhunës kryhen ndaj (ish-) bashkëshortes ose ndaj një personi me të cilin autori i dhunës ka pasur një marrëdhënie të barasvlershme, pavarësisht nëse bashkëjetojnë apo jo. Në **Belgjikë**, Kodi Penal nuk e parashikon dhunën në familje si vepër penale të veçantë. Por, nëse dhunën fizike e kryen bashkëshorti, ish-bashkëshorti apo partneri, konsiderohet si një krim më i rëndë dhe ndëshkohet me sanksione më të rënda.

Ndalimi i proceseve të detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve ose dënimit

Janë të ndaluara proceset e detyrueshme të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve në rastet kur kemi dhunë, duke qenë se procesi i ndërmjetësimit nuk mund të jetë kurrë i barabartë midis viktimës dhe dhunuesit. Nëse ndodh një akt dhune i parashikuar në këtë Konventë, atëherë ky akt përbën vepër penale dhe duhet të ndëshkohet si vepër penale. Nëse dhunuesi urdhërohet të paguajë një gjobë, Palët duhet të sigurohen që kjo të mos sjellë tërthorazi vështirësi financiare për viktimën. Viktimat janë shpesh anëtarë të së njëjtës familje me dhunuesin dhe çdo gjobë mund të ndikojë në të ardhurat e familjes apo në pagesën e detyrimit ushqimor.

Hetimi, ndjekja penale, dispozitat procedurale dhe masat mbrojtëse

Kapitulli VI i Konventës

Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut

Shumë viktimë kërcënohen me dhunë të rëndë e madje dhe vdekje nga dhunuesi, sidomos nëse ikin prej tij ose kur dhunuesi vihet përballë përgjegjësisë penale. Për të ofruar mbrojtje për viktimën në të gjitha fazat e hetimit, duhet bërë vlerësimi i nivelit të rrezikut me të cilin përballë viktimë nga të gjitha autoritetet përkatëse bashkërisht dhe duhet hartuar një plan për ta menaxhuar rrezikun në fjalë. Vlerësimi duhet të konstatojë nëse dhunuesi zotëron ose mund të gjejë armë zjarri. Në këto raste, Palët mund të miratojnë masa që mundësojnë konfiskimin e menjëhershëm të çdo arme zjarri dhe municioni, për të mbrojtur viktimën.

Në **Mbretërinë e Bashkuar**, Konferencat shumëdikasteriale të vlerësimit të rrezikut takohen një herë në muaj për të shkëmbyer informacione dhe për të marrë masa për të parandaluar dëmtimin e viktimave dhe të fëmijëve të tyre. Ato krijojnë lidhje mes autoriteteve të ndryshme dhe ofruesve të shërbimeve, siç janë policia, shërbimi i provës, pushteti vendor, shërbimet shëndetësore dhe të strehimit, strehëzat dhe shërbimet mbështetëse. Konferencat shumëdikasteriale të vlerësimit të rrezikut hartojnë plane individuale për të rritur sigurinë e viktimave. Këto konferenca janë thelbësore për të identifikuar dhe eliminuar boshllëqet në informacion.

Urdhrat e menjëhershëm të ndalimit

Për të siguruar mbrojtje të menjëhershme për viktimën, Konventa parashikon që autori i dhunës në familje të largohet nga banesa, duke vendosur kështu një distancë fizike midis tyre për të parandaluar dhunën e mëtejshme. Largimi i dhunuesit nga banesa, edhe sikur të jetë pronar i saj, parandalon shkaktimin e një traume të mëtejshme viktimës, e cila, përndryshe, do të detyrohej të largohej

nga shtëpia, shpesh së bashku me fëmijët, për të qenë larg rrezikut. U takon Palëve të vendosin se cilit autoritet do t'i jepet kompetenca për të lëshuar urdhrat e ndalimit, por përparësi i jepet gjithmonë sigurisë së viktimave apo personave në rrezik.

Urdhrat e kufizimit dhe të mbrojtjes

Palët duhet të garantojnë që viktimat e çdo forme dhune të mbuluar nga Konventa të kenë mundësi të sigurojnë urdhra kufizimi dhe mbrojtjeje me qëllim që dhunuesi të mos ketë kontakt me viktimën për një periudhë të caktuar kohore. Për të siguruar mbrojtje të menjëhershme këto urdhra duhet të jenë:

- ▶ të përballueshëm;
- ▶ të vlefshëm për mbrojtje të menjëhershme;
- ▶ të mund të merren nga viktimat pavarësisht nëse dhunuesi është përfshirë në ndonjë proces tjetër gjyqësor;
- ▶ të lejohet të paraqiten në procedime gjyqësore të mëtejshme;
- ▶ të mund të merren edhe vetëm me kërkesën e një pale;
- ▶ të mos cenojnë të drejtat të pandehurit për një proces të rregullt gjyqësor.

Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje në **Austri** i jep policisë të drejtën për ta nxjerrë nga banesa e përbashkët autorin e dhunës në familje për një periudhë dhjetëditore, si masë parandaluese, pa qenë nevoja për të marrë pëlqimin ose kërkesën e viktimës (procedimi kryesisht). Brenda 24 orëve, policia duhet t'i përcjellë një raport një qendre ndërhyrjesh, e cila i ofron viktimës këshillim të gjithanshëm. Një prej synimeve të këtij këshillimi është t'i jepet mundësi viktimës të marrë një vendim të informuar, për të ngritur apo jo padi pranë një gjykate familjare për një urdhër afatgjatë mbrojtjeje, që zgjat deri në tre muaj. Përfutuesit e këtyre urdhrave të mbrojtjes përfshijnë jo vetëm bashkëshortet dhe partneret por edhe një rreth të gjerë viktimash të mundshme, siç janë të gjithë personat që jetojnë së bashku në një organizim të tipit familjar.

Masat e mbrojtjes

Palëve u kërkohet të miratojnë një varg masash mbrojtëse për të siguruar një proces gjyqësor që respekton të drejtat dhe interesat e viktimave dhe për të shmangur traumën e mëtejshme gjatë procesit gjyqësor, në veçanti:

- ▶ duke siguruar që viktima dhe familja dhe dëshmitarët të jenë të mbrojtur nga hakmarrja dhe kërcënimi;
- ▶ duke ofruar informacion për viktimat për vendndodhjen e autorit të veprës, sidomos në rastet kur viktima është në rrezik të veçantë;
- ▶ duke i informuar ato për shërbimet në dispozicion të tyre, ecurinë e hetimit dhe rezultatin e çështjes së tyre;
- ▶ duke bërë të mundur që viktimat të dëgjohen, të paraqesin prova e të dëshmojnë jo në prani të dhunuesit dhe t'u mbrohet jeta private dhe identiteti;
- ▶ duke u siguruar viktimave shërbime gjuhësore pa pagesë kur ato janë palë në proces ose kur paraqesin prova.

Migrimi dhe azili

Kapitulli VII i Konventës

Gratë migruese dhe refugjate janë veçanërisht në pozita të pambrojtura nga dhuna. Kështu, Konventa e ndalon diskriminimin për shkaqe të statusit si migruese apo refugjate kur bëhet fjalë për zbatimin e dispozitave të saj. Gjithashtu, Konventa kërkon që të merren masa për ta parandaluar dhunën dhe për t'i mbështetur viktimat, duke marrë në konsideratë nevojat e personave të pambrojtur.

Statusi i vendbanimit

Shumica e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës kërkojnë që bashkëshortët ose partnerët të qëndrojnë të martuar ose të jenë bashkë për një periudhë kohe përpara se t'u jepet statusi i vendbanimit. Si rezultat, shumë gra migruese dhe refugjate kanë frikë të largohen nga situata e dhunës për shkak se mund të humbasin

të drejtën e vendbanimit. Konventa parashikon mundësinë e një të drejte vendbanimi autonome për gratë migruese të cilat janë viktimat të dhunës dhe u jep mundësi viktimave migruese të cilat janë shtrënguar të lidhin martesë në një vend tjetër që ta rifitojnë statusin e vendbanimit.

Konventa u lejon Palëve të rezervojnë të drejtën për të mos i zbatuar dispozitat në lidhje me statusin e vendbanimit ose për t'i zbatuar ato vetëm në raste apo kushte specifike.

Kërkesat për azil me bazë gjinore

Gratë që kërkojnë azil kanë shqetësime specifike sa i takon mbrojtjes, të cilat ndryshojnë nga ato të burrave. Gratë mund të mos jenë në gjendje apo të gatshme për ta raportuar dhunën e pësuar prej tyre, si përdhunimi, gjatë një procesi të përcaktimit të statusit si refugjatë që nuk i respekton dallimet kulturore. Ato janë shpesh të ekspozuara ndaj ngacmimit seksual dhe shfrytëzimit seksual dhe nuk janë në gjendje ta mbrojnë veten. Për të trajtuar çështjet e veçanta të lidhura me gratë që kërkojnë azil, Konventa vendos një detyrim:

- ▶ për të njohur dhunën me bazë gjinore si një formë persekutimi në kuptim të Konventës së vitit 1951 lidhur me Statusin e Refugjatëve;
- ▶ për të siguruar që një interpretim me ndjeshmëri gjinore të jepet gjatë përcaktimit të statusit të refugjatit;
- ▶ për të miratuar procedura, udhëzime dhe shërbime mbështetëse të ndjeshme nga pikëpamja gjinore në procesin e azilit, të cilat lejojnë të merren në konsideratë dallimet mes grave dhe burrave.

Kjo dispozitë dhe dispozita e moskthimit (më poshtë) përputhen dhe nuk dalin përtej Konventës së vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve dhe nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas interpretimit që i bën Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Në vitin 2002, **Komisionari i Lartë i OKB-së për Refugjatët** (UNHCR) nxori Udhëzimin për Mbrojtjen Ndërkombëtare: Persekutimi i Lidhur me Përkatësinë Gjinore në kuadër të nenit

1A pika 2 të Konventës së vitit 1951 dhe/ose Protokollit të vitit 1967 në lidhje me Statusin e Refugjatëve. Udhëzimi ka për synim të ofrojë orientime interpretuese për qeveritë, juristët, vendimmarrësit dhe gjyqësorin, si edhe për stafin e UNHCR-së që bëjnë përcaktimin e statusit të refugjatit në terren.

Parimi i moskthimit (non-refoulement)

Konventa vendos detyrimin për të siguruar që viktimat të cilët kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, pavarësisht statusit, të mos kthehen në vendet ku ndodhen në rrezik ose ku mund të bëhen objekt i torturave ose trajtimit a ndëshkimit çnjerëzor apo poshtërues. Parimi i moskthimit është një parim i njohur i azilit dhe i mbrojtjes së refugjatëve dhe i mbrojtjes ndërkombëtare të refugjatëve.

Mekanizmi i monitorimit

Kapitulli IX i Konventës

Për të siguruar që Konventa të zbatohet në mënyrë të efektshme nga Palët, do të ngrihet një mekanizëm mbikëqyrës pas hyrjes në fuqi të saj. Mekanizmi do të përbëhet nga dy organe:

- ▶ **Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje** – një organ teknik i quajtur “GREVIO” që përbëhet nga 10 deri në 15 anëtarë, që janë ekspertë për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje apo për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave. Ky grup përbëhet nga shtetas të Palëve të Konventës dhe do të ketë një ekuilibër gjinor, disiplinor dhe gjeografik. Roli i këtij grupi është të masë shkallën me të cilën e kanë zbatuar Konventën Palët.
- ▶ **Komiteti i Palëve** – është një organ politik që përbëhet nga përfaqësuesit e Palëve në Konventë, të cilët do të zgjedhin anëtarët e grupit GREVIO nga kandidatët e propozuar nga Palët.

Procedura

GREVIO do të marrë raporte nga Palët të Konventës mbështetur në një pyetësor që do të përgatisë. Ai mund të marrë informacion edhe nga OJQ-të dhe nga shoqëria civile, institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Asambleja Parlamentare dhe organe të tjera të specializuara të Këshillit të Evropës ose të ngritura nga instrumente të tjera ndërkombëtare, siç është Komiteti CEDAW. Nëse informacioni që i jepet nuk është i mjaftueshëm ose nëse një çështje e veçantë kërkon vëmendje të ngutshme, GREVIO mund të bëjë një vizitë në vend në bashkëpunim me autoritetet kombëtare të vendit në fjalë.

Në bazë të informacioneve që merr, GREVIO do të hartojë një raport mbi të cilin Pala në fjalë mund të japë komentet e veta. Këto komente do të merren në konsideratë në raportin përfundimtar dhe GREVIO ia paraqet përfundimet Komitetit të Palëve. Komiteti i Palëve mund të miratojë rekomandime në bazë të përfundimeve të GREVIO-s, për t'u zbatuar nga Pala në fjalë brenda një date të caktuar.

Rekomandimet e përgjithshme

GREVIO mund të miratojë rekomandime që nuk janë specifike për asnjë Palë, por që trajtojnë shqetësime të cilat u drejtohen të gjitha Shteteve Palë dhe që ofrojnë orientime më të qarta për zbatimin e efektshëm të dispozitave të Konventës.

Përfshirja parlamentare në monitorim

Parlamentet kombëtare ftohen të marrin pjesë në mbikëqyrjen e masave të marra për zbatimin e Konventës, duke njohur rolin e rëndësishëm që luajnë në zbatimin e saj, dhe u kërkohet palëve të paraqesin raporte tek GREVIO për konsultim.

Për herë të parë në një konventë të Këshillit të Evropës, i kërkohet Asamblesë Parlamentare të shqyrtojë rregullisht zbatimin e konventës. Kjo dispozitë pranon rolin e rëndësishëm që ka luajtur

Asambleja Parlamentare për ta vendosur çështjen e dhunës ndaj grave në programet politike të Këshillit të Evropës dhe të shteteve anëtare dhe angazhimin e vazhdueshëm të saj për këtë çështje.

Marrëdhëniet me instrumentet e tjera ndërkombëtare

Kapitulli X i Konventës

Kjo dispozitë mbulon marrëdhënien midis Konventës dhe çdo instrumenti tjetër ndërkombëtar, për të siguruar bashkekzistencën në harmoni të tyre. Konventa nuk ndërhyt në të drejtat dhe detyrimet që lindin nga dispozitat e instrumenteve ndërkombëtare për çështjet që mbulon edhe Konventa, siç janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe protokollet e saj dhe Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave dhe Protokollit Fakultativ i saj. Konventa është hartuar për ta fuqizuar mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje.

Palët e Konventës nxiten pozitivisht të punojnë së bashku përmes marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe në çështje që trajtohen në Konventë, përforcimin e dispozitave të saj ose lehtësimin e zbatimit të parimeve të shprehura në të.

Klauzola të fundit

Kapitulli XII i Konventës

Hyrja në fuqi

Konventa është e hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, Shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj (Kanadaja, Selia e Shenjtë, Japonia, Meksika dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës) dhe Bashkimi Evropian.

Konventa hyn në fuqi pasi të jetë nënshkruar dhe ratifikuar nga 10 shtete, duke përfshirë të paktën 8 Shtete anëtare të Këshillit të Evropës.

Aderimi

Pas hyrjes në fuqi, mund të ftohet çdo Shtet jo anëtar i Këshillit të Evropës, për të aderuar në Konventë.

Rezervat

Palët mund deklarojnë rezerva vetëm për nenet për të cilat lejohet shprehimisht kjo gjë dhe për një periudhë prej pesë vjetësh, që mund të rinovohet vetëm një herë. Mundësia e deklarimit të rezervave duhet t'u japë mundësi sa më shumë shteteve për ta ratifikuar Konventën, duke u lejuar më shumë kohë për ta përshtatur legjislacionin e tyre për çështje të veçanta.

Rezervat janë të mundura në lidhje me:

- ▶ Nenin 30 (Kompensimi), paragrafi 2;
- ▶ Nenin 44 (Juridiksioni), paragrafët 1.e, 3 dhe 4;
- ▶ Nenin 55 (Procedimet *ex parte* dhe *ex officio*), paragrafi 1 në lidhje me Nenin 35 për shkeljet e lehta;
- ▶ Nenin 58 (Parashkrimi) në lidhje me Nenet 37, 38 dhe 39;
- ▶ Nenin 59 (Statusi i vendbanimit);

Palët mund të rezervojnë edhe të drejtën të parashikojnë sanksione jo-penale, në vend të sanksioneve penale, për Nenet 33 (dhuna psikologjike) dhe 34 (përndjekja).

Rezervat duhen deklaruar kur nënshkruhet ose ratifikohet Konventa dhe mund të tërhiqen përmes një deklarate që depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Pas pesë vjetësh rezervat bien, nëse nuk rinovohen. Nëse një palë vendos t'i rinovojë rezervat e veta, Palës i kërkohet të informojë GREVIO-n për arsyet.

Pasthënie e Zëvendëssekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës



Nuk ka asnjë dyshim: Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë probleme të cilat prekin të gjitha segmentet e shoqërisë dhe janë të përhapura në të gjitha shtetet tona anëtare. Dhuna seksuale dhe përdhunimi, ngacmimi seksual, martesë e detyruar, gjymtimi i organeve gjentile femërore, keqpërdorimi fizik, seksual dhe psikologjik nga partneri dhe aborti e sterilizimi i detyruar janë një realitet i zyrtë për një numër shumë të madh grash në Evropë dhe në mbarë botën.

Konventa e Stambollit bazohet në idenë se dhuna ndaj grave është një formë e dhunës për arsye të përkatësisë gjinore e cila kryhet ndaj grave për shkak se janë gra dhe se gratë preken më shumë se burrat nga kjo dhunë. Duke qenë se kemi të bëjmë me të drejtat e njeriut, shtetet e kanë për detyrë t'u japin zgjidhje të gjitha formave të dhunës dhe të bëjnë hapa për ta parandaluar dhunën, për t'i mbrojtur viktimat dhe për t'i ndjekur penalisht autorët e këtyre akteve. Duhet të jemi të qartë: Nuk mund të ketë barazi të vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, nëse gratë pësojnë dhunë gjinore në masë dhe agjencitë dhe institucionet shtetërore e bëjnë syrin qorr.

Megjithëse Konventa e Stambollit trajton format e dhunës të kryer ndaj grave, ajo nuk e anashkalon faktin se edhe burrat, fëmijët dhe të moshuarit mund të dhunohen brendapërbrenda familjes. Për t'u ofruar mbështetje dhe mbrojtje të gjithë atyre që kanë nevojë

për të, Palët e Konventës së Stambollit nxiten të zbatojnë masat e parashikuara për të gjitha viktimat e dhunës në familje.

Asambleja Parlamentare ka kohë që kërkon ta promovojë barazinë gjinore dhe t'i nxisë qeveritë t'u japin zgjidhje problemeve të ngutshme që paraqet diskriminimi ndaj grave. Duke e pranuar dhunën ndaj grave si një pengesë madhore për barazinë gjinore, si një shkelje të të drejtave të njeriut dhe si një rrezik që u kanoset shoqërive tona, Asambleja Parlamentare ka luajtur një rol të ndjeshëm për të nxitur vendosjen e një pakete të gjithanshme standardesh me fuqi detyruese ligjore për ta luftuar këtë dhunë, si përpara ashtu edhe gjatë negociatave në lidhje me Konventën e Stambollit. Pjesërisht, Traktati është maja e këtyre përpjekjeve dhe përbën paketën më të rëndësishme ndërkombëtare të masave të cilat janë në gjendje të sjellin ndryshimin. Kam besim tek angazhimi i vazhdueshëm i Asamblesë për ta promovuar aktivisht Konventën. Negocimi i tekstit prodhoi një forcë të fuqishme shtytëse politike për ta luftuar dhunën ndaj grave. Është thelbësore të mbështetemi tek kjo forcë shtytëse në mënyrë që të sigurohemi që traktati të hyjë në fuqi sa më shpejt.

Me këtë manual, parlamentarëve u vihet në dispozicion një instrument praktik për t'i bërë publicitet më gjerësisht Konventës së Stambollit dhe për të shpjeguar dispozitat e saj dhe arsyet përse këto dispozita janë kaq të rëndësishme. Jam e sigurt se do të gjeni argumentet bindëse që i kërkon situata. Gratë e Evropës dhe të mbarë botës kanë besim tek mbështetja juaj.

Gabriella Battaini-Dragoni,
*Zëvendëssekretare e Përgjithshme
e Këshillit të Evropës*

Shtojca I

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje

(CETS Nr. 210)

Stamboll, 11 maj 2011.

Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera nënshkruese të kësaj Konvente,

Duke rikujtuar Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ETS Nr. 5, 1950) dhe Protokollet e saj, Kartën Sociale Evropiane (ETS Nr. 35, 1961, të rishikuar në 1996, ETS Nr. 163), Konventën e Këshillit të Evropës mbi Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (CETS Nr. 197, 2005) dhe Konventën e Këshillit të Evropës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (CETS Nr. 201, 2007);

Duke rikujtuar rekomandimet e mëposhtme të Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës: Rekomandimin Rec (2002)5 mbi mbrojtjen e grave nga dhuna, Rekomandimin CM/Rec (2007)17 mbi standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore, Rekomandimin CM/Rec (2010)10 mbi rolin e burrave dhe grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe vendosjen e paqes, dhe rekomandime të tjera përkatëse;

Duke marrë parasysh numrin në rritje të praktikave gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila cakton standarde të rëndësishme në fushën e dhunës kundër grave;

Duke patur parasysh Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966), Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966), Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave ("CEDAW", 1979) dhe Protokollin e saj Opsional (1999), si dhe Rekomandimin e Përgjithshëm Nr 19 të Komitetit CEDAW mbi dhunën kundër grave, Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve (1989) dhe Protokollet e saj Opsionale (2000) dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006);

Duke patur parasysh Statutin e Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale (2002);

Duke rikujtuar parimet bazë të të drejtës ndërkombëtare humanitare, dhe veçanërisht Konventën e Gjenevës (IV) në lidhje me Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Luftë (1949) dhe Protokollet e saj Shtesë I dhe II (1977);

Duke dënuar të gjitha format e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

Duke pranuar se realizimi i barazisë *de jure* dhe *de facto* midis burrave dhe grave është një element kyç në parandalimin e dhunës kundër grave;

Duke pranuar se dhuna kundër grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave, që kanë çuar në dominim dhe diskriminim të grave nga burrat dhe kanë penguar përparimin e të plotë të grave;

Duke pranuar natyrën strukturore të dhunës kundër grave si dhunë gjinore, dhe se dhuna kundër grave është një prej mekanizmave thelbësorë socialë me të cilin gratë janë të detyruara të vendosen në një pozicion varësie në krahasim me burrat;

Duke pranuar me shqetësim të thellë se gratë dhe vajzat janë shpesh të ekspozuara ndaj formave serioze të dhunës, si për shembull dhuna në familje, ngacmimi seksual, përdhunimi, martesë e detyruar, krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit “nder” dhe gjymtimi i organeve gjinitale, që përbën shkelje të rëndë të të drejtave të grave dhe vajzave dhe pengesë kryesore për arritjen e barazisë midis burrave dhe grave;

Duke pranuar shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut gjatë konflikteve të armatosura që prekin popullsinë civile, veçanërisht gratë, në formën e një përdhunimi të përhapur ose sistematik dhe dhunës seksuale dhe mundësisë për rritje të dhunës gjinore si gjatë edhe pas konflikteve;

Duke pranuar se gratë dhe vajzat janë më të ekspozuara sesa burrat ndaj një rreziku më të lartë të dhunës gjinore;

Duke pranuar se dhuna në familje prek gratë në mënyrë disproporcionale, dhe se burrat gjithashtu mund të jenë viktimat e dhunës në familje;

Duke pranuar se fëmijët janë viktimat e dhunës në familje, përfshirë rastet si dëshmitarë të dhunës në familje;

Duke aspiruar të krijojnë një Evropë pa dhunë kundër grave dhe pa dhunë në familje,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Kapitulli I – Qëllimet, përkufizimet, barazia dhe mosdiskriminimi, detyrime të përgjithshme

Neni 1 – Qëllimet e Konventës

1. Qëllimet e kësaj Konvente janë:
 - a. mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës, dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
 - b. kontributi ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave, duke përfshirë mënyrat me anë të fuqizimit të grave;
 - c. hartimi i një kuadri gjithëpërfshirës politikash dhe masash për mbrojtjen dhe ndihmën për të gjitha viktimat e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
 - d. nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar, me synim eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
 - e. ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përjasjeje të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.
2. Me qëllim garantimin e zbatimit efektiv të dispozitave të saj nga Palët, kjo Konventë krijon një mekanizëm specifik monitorimi.

Neni 2 – Objekti i Konventës

1. Kjo Konventë zbatohet për të gjitha format e dhunës kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje, e cila prek gratë në mënyrë disproporcionale.
2. Palët inkurajohen të zbatojnë këtë Konventë për të gjitha viktimat e dhunës në familje. Palët i kushtojnë vëmendje të veçantë grave viktimat të dhunës gjinore, në zbatim të dispozitave të kësaj Konvente.
3. Kjo Konventë zbatohet në kohë paqeje dhe në situata konflikti të armatosur.

Neni 3 – Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Konvente:

- a. “dhunë kundër grave” kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private;
- b. “dhunë në familje” nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën;
- c. “gjini” nënkupton rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë;
- d. “dhunë gjinore kundër grave” nënkupton dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale;
- e. “viktimë” nënkupton çdo person fizik që i nënshtrohet sjelljes së përcaktuar në pikat a dhe b;
- f. “gra” përfshin vajzat nën moshën 18 vjeç.

Neni 4 – Të drejtat themelore, barazia dhe mosdiskriminimi

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera për të promovuar dhe mbrojtur të drejtën për çdokënd, veçanërisht gratë, për të jetuar pa dhunë në sferën publike, si dhe në atë private.
2. Palët dënojnë të gjitha format e diskriminimit kundër grave dhe marrin pa vonesë masat legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për t'i parandaluar, veçanërisht me anë të:
 - shprehjes së parimit të barazisë midis burrave dhe grave në kushtetutat e tyre kombëtare ose në ndonjë legjislacion tjetër përkatës, duke garantuar realizimin praktik të këtij parimi;
 - ndalimit të diskriminimit kundër grave, veçanërisht nëpërmjet ushtrimit të sanksioneve, sipas rastit;
 - shfuqizimit të ligjeve dhe praktikave që diskriminojnë gratë.
3. Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga Palët, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie nënjë pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.
4. Masat e veçanta që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna gjinore nuk konsiderohen diskriminim sipas kushteve të kësaj Konvente.

Neni 5 – Detyrimet e shtetit dhe masat paraprake

1. Palët i shmangen përfshirjes në akte dhune kundër grave dhe garantojnë që autoritetet Shtetërore, zyrtarët, agjentët, institucionet dhe aktorë të tjerë që veprojnë në emër të Shtetit, të veprojnë në përputhje me këtë detyrim.
2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për të ushtruar masa paraprake për të parandaluar,

hetuar, dënuar dhe siguruar kompensim për akte dhune të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, të cilat kryhen nga aktorë joshтетërorë.

Neni 6 – Politikat me ndjeshmëri gjinore

Palët marrin përsipër të përfshijnë një perspektivë gjinore në zbatimin dhe vlerësimin e ndikimit të dispozitave të kësaj Konvente dhe të nxisin dhe zbatojnë në mënyrë efektive politikat e barazisë midis burrave dhe grave, dhe fuqizimin e grave.

Kapitulli II – Politikat e integruara dhe mbledhja e të dhënave

Neni 7 – Politikat gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera për të miratuar dhe zbatuar politika mbarëkombëtare efektive, gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara që përfshijnë të gjitha masat përkatëse për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente dhe që ofrojnë reagim holistik ndaj dhunës kundër grave.
2. Palët garantojnë që politikat e përmendura në paragrafin 1 të vendosin të drejtat e viktimës në qendër të të gjitha masave dhe të zbatohen me anë të bashkëpunimit efektiv ndërmjet të gjitha agjencive, institucioneve dhe organizatave përkatëse.
3. Masat e marra sipas këtij neni përfshijnë, sipas rastit, të gjithë aktorët përkatës, si për shembull agjencitë shtetërore, parlamentet dhe autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile.

Neni 8 – Burimet financiare

Palët shpërndajnë burimet e përshtatshme financiare dhe njerëzore për zbatimin e duhur të politikave, masave dhe programeve të integruara për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës

të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, duke përfshirë ato që janë kryer nga organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile.

Neni 9 – Organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile

Palët pranojnë, nxisin dhe mbështesin, në të gjitha nivelet, punën e organizatave përkatëse joqeveritare dhe të shoqërisë civile, aktive në luftën e dhunës kundër grave dhe krijimin e bashkëpunimit efektiv me këto organizata.

Neni 10 – Organi bashkërendues

1. Palët caktojnë ose krijojnë një ose më shumë organe zyrtare përgjegjëse për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga kjo Konventë. Këto organe bashkërendojnë mbledhjen e të dhënave të përmendura në Nenin 11, si dhe analizojnë dhe publikojnë rezultatet e tyre.
2. Palët garantojnë që organet e caktuara ose të krijuara sipas këtij neni të marrin informacion të një natyre të përgjithshme mbi masat e marra sipas Kapitullit VIII.
3. Palët garantojnë që organet e caktuara ose të krijuara sipas këtij neni të kenë aftësinë për të komunikuar drejtpërdrejt dhe për të forcuar marrëdhëniet me homologët e tyre tek Palët e tjera.

Neni 11 – Mbledhja dhe kërkimi i të dhënave

1. Për qëllim të zbatimit të kësaj Konvente, Palët marrin përsipër:
 - a. të mbledhin të dhëna përkatëse të zberthyera statistikore, në intervale të rregullta kohore, në lidhje me rastet e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente;
 - b. të mbështesin kërkimin në fushën e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, me qëllim shqyrtimin e arsyeve fillestare dhe pasojave, niveleve të shpeshtësisë dhe dënimit, si dhe efikasitetit të masave të marra për zbatimin e kësaj Konvente.

2. Palët përpiqen të kryejnë studime të bazuara në popullsi, në intervale të rregullta kohore, për të vlerësuar shpeshhtësinë dhe tendencat në të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj konvente.
3. Palët sigurojnë grupin e ekspertëve të përmendur në nenin 66 të kësaj konvente, me informacionin e mbledhur sipas këtij neni, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mundësimin e vlerësimit krahasues ndërkombëtar.
4. Palët garantojnë që informacioni i mbledhur sipas këtij neni t'i vihet në dispozicion publikut.

Kapitulli III - Parandalimi

Neni 12 – Detyrimet e përgjithshme

1. Palët marrin masat e nevojshme për të promovuar ndryshime në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave, me synim çrrënjosjen e paragjykimeve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera që bazohen në idenë e inferioritetit të grave ose në rolet e stereotipizuara për burrat dhe gratë.
2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera për të parandaluar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente nga çdo person fizik ose juridik.
3. Çdo masë e marrë sipas këtij kapitulli merr në konsideratë nevojat specifike të personave pa mbrojtje për shkak të rrethanave të veçanta dhe i japin prioritet të drejtave të të gjitha viktimave.
4. Palët marrin masat e nevojshme për të inkurajuar të gjithë anëtarët e shoqërisë, veçanërisht burrat dhe djemtë, që të kontribuojnë në mënyrë aktive në parandalimin e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.
5. Palët garantojnë që kultura, zakonet, feja, tradita ose i ashtuquajturit “nder” të mos konsiderohen si justifikim për çdo akt dhune të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente.

6. Palët marrin masat e nevojshme për të promovuar programe dhe aktivitete për fuqizimin e grave.

Neni 13 – Rritja e ndërgjegjësimit

1. Palët promovojnë ose realizojnë rregullisht dhe në të gjitha nivelet, fushata ose programe të rritjes së ndërgjegjësimit, duke përfshirë ato në bashkëpunim me institucionet kombëtare të drejtave të njeriut dhe organet e barazisë, shoqërisë civile dhe organizatat joqeveritare, veçanërisht organizatat e grave, sipas rastit, për të rritur ndërgjegjësimin dhe perceptimin nga publiku i gjerë, në lidhje me manifestimet e ndryshme të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, pasojat e tyre për fëmijët dhe nevojën për të parandaluar një dhunë të tillë.
2. Palët garantoj në nivel të lartë shpërndarjeje për publikun e gjerë, të informacionit mbi masat e vëna në dispozicion për parandalimin e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

Neni 14 – Arsimi

1. Sipas rastit, Palët marrin hapat e nevojshme për të përfshirë materiale mësimore mbi çështje të tilla si barazia midis burrave dhe grave, rolet gjinore të pasteriotipizuara, respekti i ndërsjellë, zgjidhja e konflikteve pa dhunë në marrëdhëniet ndërpersonale, dhuna gjinore kundër grave dhe e drejta për integritet personal, të përshtatura me kapacitetin në zhvillim të nxënësve në programet mësimore zyrtare dhe në të gjitha nivelet arsimore.
2. Palët marrin hapat e nevojshme për të promovuar parimet e përmendura në paragrafin 1 nëmjediset informale arsimore, si dhe në mjedise sportive, kulturore dhe argëtuese dhe media.

Neni 15 – Trajnimi i profesionistëve

1. Palët sigurojnë ose forcojnë trajnimin e duhur për profesionistët përkatës që merren me viktimat ose autorët e të gjitha akteve të dhunës të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente, mbi

parandalimin dhe zbulimin e një shkeljeje të tillë, barazinë midis burrave dhe grave, nevojat dhe të drejtat e viktimave, si dhe mënyrën e parandalimit të viktimizimit dytësor.

2. Palët inkurajojnë që trajnimi i përmendur në paragrafin 1 të përfshijë trajnim për bashkëpunimin e bashkërenduar midis shumë agjencive, për të lejuar një trajtim gjithëpërfshirës dhe të duhur të referimeve në rastet e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

Neni 16 – Ndërhyrja parandaluese dhe programet e trajtimit

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të krijuar ose mbështetur programe që synojnë edukimin e autorëve të dhunës në familje që të përdorin një sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale, me synim parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe ndryshimin e modeleve të dhunshme të sjelljes.
2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të krijuar ose mbështetur programe trajtimi që synojnë parandalimin e autorëve, veçanërisht autorëve të krimeve seksuale, nga përsëritja e veprës.
3. Në marrjen e masave të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, Palët garantojnë që siguria, mbështetja dhe të drejtat e viktimave të jenë shqetësim parësor dhe, sipas rastit, këto programe të krijohen dhe zbatohen në bashkërendim të ngushtë me shërbimet mbështetëse të specialistëve për viktimat.

Neni 17 – Pjesëmarrja e sektorit privat dhe medias

1. Palët nxisin sektorin privat, sektorin e teknologjisë së komunikimit dhe informacionit dhe medias, në lidhje me lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e tyre, për të marrë pjesë në përpunimin dhe zbatimin e politikave dhe për të caktuar udhëzime dhe standarde vetërregullatore për parandalimin e dhunës kundër grave dhe rritjen e respektit për dinjitetin e tyre.

2. Palët zhvillojnë dhe promovojnë, në bashkëpunim me aktorët e sektorit privat, aftësitë midis fëmijëve, prindërve dhe edukatorëve përmënyrën si të trajtojnë mjedisin e informacionit dhe komunikimit që ofron akses ndaj përmbajtjes degraduese të një natyre seksuale ose të dhunshme, e cila mund të ishte e dëmshme.

Kapitulli IV – Mbrojtja dhe mbështetja

Neni 18 – Detyrimet e përgjithshme

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislativë ose masa të tjera për të mbrojtur të gjitha viktimat nga akte të mëtejshme dhune.
2. Palët marrin masat e nevojshme legjislativë ose masa të tjera në pajtim me ligjin e brendshëm, për të garantuar ekzistencën e mekanizmave të duhur për të parashikuar bashkëpunim efektiv midis të gjitha agjencive shtetërore përkatëse, duke përfshirë gjyqësorin, prokurorët publikë, agjencitë e zbatimit të ligjit, autoritetet vendore dhe rajonale, si dhe organizatat joqeveritare dhe organizata dhe ente të tjera përkatëse, në mbrojtje dhe mbështetje të viktimave dhe dëshmitarëve të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, duke përfshirë ato me anë të referencës ndaj shërbimeve të përgjithshme dhe mbështetëse të specializuara, siç përcaktohen hollësisht në Nenet 20 dhe 22 të kësaj Konvente.
3. Palët garantojnë që masat e marra sipas këtij kapitulli:
 - të bazohen në një perceptim gjinor të dhunës kundër grave dhe dhunës në familje dhe të fokusohen tek të drejtat e njeriut dhe siguria e viktimës;
 - të bazohen në një përqasje të integruar, e cila merr parasysh marrëdhënien midis viktimave, autorëve të veprave penale, fëmijëve dhe mjedisit të tyre më të gjerë social;
 - të synojnë shmangien e viktimizimit dytësor;

- të synojnë fuqizimin dhe pavarësinë ekonomike të grave, viktimat të dhunës;
 - të lejojnë, sipas rastit, një gamë mbrojtjeje dhe shërbimesh mbështetëse që duhet të vendosen në të njëjtat ambiente;
 - të trajtojnë nevojat specifike të personave të pambrojtur, duke përfshirë viktimat fëmijë dhe t'u vihen në dispozicion.
4. Sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një autori vepre penale.
 5. Palët marrin masat e duhura për të ofruar mbrojtje konsullor edhe mbrojtje dhe mbështetje tjetër për shtetasit e tyre dhe viktimat të tjera që kanë të drejtën e kësaj mbrojtjeje, në përputhje me detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare.

Neni 19 – Informimi

Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të marrin informacion të mjaftueshëm dhe në kohë, në një gjuhë që kuptojnë, në lidhje me shërbimet e disponueshme mbështetëse dhe masat ligjore.

Neni 20 – Shërbimet e përgjithshme mbështetëse

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë akses në shërbime që lehtësojnë rehabilitimin e tyre nga dhuna. Këto masa duhet të përfshijnë, sipas nevojës, shërbime të tilla si konsulenca ligjore dhe psikologjike, ndihma financiare, strehimi, arsimit, trajnimit dhe ndihma në gjetjen e një pune.
2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë akses në shërbime sociale dhe në kujdes shëndetësor, dhe që shërbimet të kenë burime të mjaftueshme dhe profesionistët të jenë trajnuar për të ndihmuar viktimat dhe për t'i drejtuar ata tek shërbimet përkatëse.

Neni 21 – Ndhimja për ankesat individuale/kolektive

Palët garantojnë që viktimat të kenë informacion dhe akses në mekanizmat ndërkombëtarë të ankesave individuale/kolektive. Palët nxisin ofrimin e ndihmës sensitive dhe të specializuar për viktimat në paraqitjen e këtyre kërkesave.

Neni 22 – Shërbimet mbështetëse të specializuara

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar ose caktuar, në një shpërndarje të mjaftueshme gjeografike, shërbime të menjëhershme, afatshkurtra dhe afatgjata mbështetëse të specializuara për çdo viktimitë që i nënshtrohet një akti dhune të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente.
2. Palët sigurojnë ose caktojnë shërbime mbështetëse të specialisteve femra për të gjitha gratë, viktimat të dhunës, dhe fëmijët e tyre.

Neni 23 – Strehat

Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të parashikuar ngritjen e strehave të përshtatshme, lehtësisht të aksesueshme e në numër të mjaftueshëm, për të ofruar strehim të sigurt dhe për të përdorur përjasje proaktive ndaj viktimave, veçanërisht grave dhe fëmijëve të tyre.

Neni 24 – Linjat telefonike të ndihmës

Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të vendosur linja telefonike falas të ndihmës mbarëkombëtare të pandërprerë (24/7) për të ofruar konsulencë për telefonuesit, fshehtësi ose respektim të anonimatit të tyre, në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

Neni 25 – Mbështetja për viktimat e dhunës seksuale

Palët marrin masa të nevojshme legjislative ose masa të tjera për të parashikuar ngritjen e një numri të mjaftueshëm të qendrave

referuese të përshtatshme, lehtësisht të aksesueshme për dhunën seksuale ose krizën nga përdhunimi, për viktimat, për të parashikuar vizita mjekësore dhe mjekoligjore, mbështetje për traumat dhe këshillim për viktimat.

Neni 26 – Mbrojtja dhe mbështetja për dëshmitarët fëmijë

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që në ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimave, të merren në konsideratë të drejtat dhe nevojat e dëshmitarëve fëmijë të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.
2. Masat e marra sipas këtij neni përfshijnë këshillimin e duhur psikosocial për dëshmitarët fëmijë të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente dhe marrin në konsideratë interesat më të mira të fëmijës.

Neni 27 – Raportimi

Palët marrin masat e nevojshme për të inkurajuar çdo dëshmitar në kryerjen e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente ose që ka arsye të mjaftueshme për të besuar se ky akt mund të kryhet, ose që priten akte të mëtejshme dhune, të njoftojë organizatat ose autoritetet kompetente.

Neni 28 – Raportimi nga profesionistët

Palët marrin masat e nevojshme për të garantuar që rregullat e fshehtësisë të vendosura nga ligji i brendshëm mbi profesionistë të caktuar, sipas kushteve përkatëse, të mos pengojnë mundësinë e njoftimit të tyre pranë organizatave ose autoriteteve kompetente, nëse kanë arsye të mjaftueshme për të besuar se është kryer një akt i rëndë dhune i mbuluar nga objekti i kësaj Konvente dhe priten akte të mëtejshme të rënda dhune.

Kapitulli V – Ligji i së drejtës dhe detyrimeve

Neni 29 – Paditë civile dhe mjetet ligjore

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t'u ofruar viktimave mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autorit të veprës penale.
2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t'u ofruar viktimave, në përputhje me parimet e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare, mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autoriteteve Shtetërore që nuk kanë mundur të përmbushin detyrën e tyre për të marrë masa të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse brenda objektivit të kompetencave të tyre.

Neni 30 – Kompensimi

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë të drejtë për të kërkuar kompensim nga autorët për çdo shkelje të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë.
2. Kompensimi i mjaftueshëm nga Shteti i jepet atyre që kanë pësuar dëme të rënda trupore ose dëme ndaj shëndetit, në shkallën që dëmi nuk mbulohet nga burime të tjera, si për shembull masa për autorët e veprave penale, sigurimin ose masa sociale ose shëndetësore të financuara nga shteti. Kjo nuk pengon Palët që të kërkojnë kthim për kompensimin e dhënë nga autori i veprës penale, për sa kohë që i kushtohet rëndësia e duhur sigurisë së viktimës.
3. Masat e marra sipas paragrafit 2 garantojnë dhënien e kompensimit brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Neni 31 – Kujdestaria, të drejtat e vizitave dhe siguria

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që, në përcaktimin e kujdestarisë dhe të drejtave të vizitave të fëmijëve, të merren në konsideratë incidentet e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që ushtrimi i vizitave ose të drejta të tjera kujdestarie të mos rrezikojnë të drejtat dhe sigurinë e viktimës ose fëmijëve.

Neni 32 – Pasojat civile të martesave të detyruara

Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që martesat e detyruara të mund të jenë të pavlefshme, të anulohen ose zgjidhen pa barra të papërshtatshme financiare ose administrative të vendosura ndaj viktimës.

Neni 33 – Dhuna psikologjike

Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e dëmtimit të qëllimshëm të integritetit psikologjik të një personi nëpërmjet shtrëngimit ose kërcënimeve.

Neni 34 – Sjelljet kërcënuese

Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e përfshirjes së qëllimshme e të vazhdueshme në sjellje kërcënuese të drejtuar ndaj një personi tjetër, që i shkakton atij ose asaj frikë për sigurinë personale.

Neni 35 – Dhuna fizike

Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e kryerjes së qëllimshme të akteve të dhunës fizike kundër një personi tjetër.

Neni 36 – Dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e sjelljeve të mëposhtme të qëllimshme:
 - a. përfshirja në depërtim të detyruar vaginal, anal ose oral të një natyre seksuale, në trupin e një personi tjetër me pjesë trupore ose objekte;
 - b. përfshirja me një person në akte të tjera të detyruara të një natyre seksuale;

- c. nxitja që një person tjetër të përfshihet me një person të tretë në akte të detyruara të një natyre seksuale.
2. Pëlqimi duhet të jepet vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit të vlerësuar në kontekstin e rrethanave më të afërta.
3. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që dispozitat e paragrafit 1 të zbatohen edhe për aktet e kryera kundër ish bashkëshortëve/partnerëve ose bashkëshortëve/partnerëve aktualë, të njohur nga ligji i brendshëm.

Neni 37 – Martesa e detyruar

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin detyrim të qëllimshëm të një të rrituri ose fëmije për të lidhur martesë.
2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e tërheqjes së qëllimshme të një të rrituri ose fëmije për të shkuar në territorin e një Pale ose Shteti të ndryshëm nga ai ku ai ose ajo banon, me qëllim detyrimin e një të rrituri ose fëmije për të lidhur martesë.

Neni 38 – Gjymtimi i organeve gjentiale femërore

Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e sjellje vetë mëposhtme të qëllimshme:

- a. prerja, infibulimi ose kryerja e ndonjë gjymtimi tjetër për të tërë ose një pjesë të buzëve të mëdha, buzëve të vogla ose klitorit të gruas;
- b. shtrëngimi ose kërkesa ndaj një gruaje që t'i nënshtrohet ndonjë prej akteve të renditura në pikën a;
- c. provokimi, shtrëngimi ose kërkesa ndaj një vajze që t'i nënshtrohet ndonjë prej akteve të renditura në pikën a.

Neni 39 – Aborti dhe sterilizimi i detyruar

Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e sjelljeve të mëposhtme të qëllimshme:

- a. kryerja e abortit të një gruaje pa pëlqimin e saj paraprak;
- b. kryerja e një operacioni kirurgjikal që ka qëllimin ose efektin e ndërprerjes së kapacitetit të një gruaje për të qenë riprodhuese në mënyrë natyrale, pa pëlqimin e saj paraprak ose kuptimin e procedurës.

Neni 40 – Ngacmimi seksual

Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, joverbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, t'i nënshtrohet një sanksioni penal ose sanksioni tjetër ligjor.

Neni 41 – Dhënia e ndihmës ose bashkëpunimi dhe tentativa

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të përcaktuar si vepër penale, kur kryhet qëllimisht, dhënien e ndihmës ose bashkëpunimin përkryerjen e veprave penale të përcaktuara në pajtim me Nenet 33, 34, 35, 36, 37, 38.a dhe 39 të kësaj Konvente.
2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të përcaktuar si vepra penale, kur kryhen qëllimisht, tentativat për të kryer veprat penale të përcaktuara në pajtim me Nenet 35, 36, 37, 38.a dhe 39 të kësaj Konvente.

Neni 42 – Justifikimet e papranueshme për krime, duke përfshirë krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit “nder”

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që, në procedimet penale të filluara pas kryerjes së një akti dhune të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente, kultura, zakoni, feja, tradita ose i ashtuquajturi “nder” të mos konsiderohen si justifikime për këto akte. Kjo mbulon veçanërisht pretendimet që viktimat ka shkelur normat ose zakonet kulturore, fetare, sociale ose tradicionale të sjelljes së duhur.

2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që nxitja e një fëmije për të kryer ndonjë prej akteve të përmendura në paragrafin 1 të mos cenojë përgjegjësinë penale të atij personi për aktet e kryera.

Neni 43 – Aplikimi i veprave penale

Veprat e përcaktuara në pajtim me këtë Konventë aplikohen pavarësisht nga natyra e marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe shkelësit.

Neni 44 – Juridiksioni

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të përcaktuar juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë, kur vepra penale është kryer:
 - a. në territorin e tyre; ose
 - b. në bordin e një anijeje që ngre flamurin e tyre; ose
 - c. në bordin e një avioni të regjistruar sipas ligjeve të tyre; ose
 - d. nga një prej shtetasve të tyre; ose
 - e. nga një person i cili ka vendqëndrimin e tij ose të saj të zakonshëm në territorin e tyre.
2. Palët përpigën të marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të përcaktuar juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë, kur vepra penale është kryer kundër një prej shtetasve të tyre ose një personi që ka vendqëndrimin e tij ose të saj të zakonshëm në territorin e tyre.
3. Për ndjekjen penale të veprave të përcaktuara në përputhje me Nenet 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente, Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që juridiksioni i tyre të mos varet nga fakti që veprat janë dënuar në territorin ku janë kryer.
4. Për ndjekjen penale të veprave të përcaktuara në përputhje me Nenet 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente, Palët marrin

masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që juridiksioni i tyre në lidhje me pikat d dhe e të paragrafit 1 të mos varet nga fakti që ndjekja penale mund të fillojë vetëm pas kallëzimit nga viktimat të veprës penale ose parashtrimit të informacionit nga Shteti i vendit ku është kryer vepra penale.

5. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të përcaktuar juridiksionin mbi veprat penale të përcaktuara në pajtim me këtë Konventë, në rastet kur autori i dyshuar është i pranishëm në territorin e tyre dhe ata nuk e ekstradojnë tek një Palë tjetër, vetëm për shkak të kombësisë së tij/të saj.
6. Kur më shumë se një Palë kërkon juridiksionin mbi një vepër të dyshuar të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë, Palët e përfshira, sipas rastit, konsultohen me njëra tjetrën, me synim përcaktimin e juridiksionit më të përshtatshëm për ndjekje penale.
7. Pa cenuar rregullat e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare, kjo Konventë nuk përjashton asnjë juridiksion penal të ushtruar nga një Palë në pajtim me ligjin e saj të brendshëm.

Neni 45 – Sanksionet dhe masat

1. Palët marrin masat e nevojshme ose masa të tjera për të garantuar që veprat penale të përcaktuara në pajtim me këtë Konventë, të dënohen me sanksione efektive, proporcionale dhe frenuese, duke marrë parasysh shkallën e kryerjes së tyre. Këto sanksione përfshijnë, sipas rastit, dënime që përfshijnë heqjen e lirisë, të cilat mund tepër bëjnë shkak për ekstradim.
2. Palët mund të marrin masa të tjera në lidhje me autorët e veprave penale, të tilla si:
 - monitorimi ose mbikëqyrja e personave të dënuar;
 - tërheqja e të drejtave prindërore, nëse interesat më të mira të fëmijës, që mund të përfshijnë sigurinë e viktimës, nuk mund të garantohen në një mënyrë tjetër.

Neni 46 – Rrethanat rënduese

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që rrethanat e mëposhtme, nëmasën që tashmë nuk janë elementë përbërës të veprës penale, në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të brendshëm, mund të merren në konsideratë si rrethana rënduese në përcaktimin e dënimit në lidhje me veprat penale të përcaktuara në pajtim me këtë Konventë:

- a. vepra penale është kryer kundër një ish bashkëshorti ose partneri ose bashkëshorti ose partneri aktual të njohur nga ligji i brendshëm, nga një anëtar familjeje, një person që bashkëjeton me viktimën ose një person që ka abuzuar me autoritetin e tij ose të saj;
- b. vepra penale ose vepra penale të ngjashme janë kryer në mënyrë të përsëritur;
- c. vepra penale është kryer kundër një personi të pambrojtur për shkak të rrethanave të veçanta;
- d. vepra është kryer kundër ose në prani të një fëmije;
- e. vepra penale është kryer nga dy ose më shumë njerëz që veprojnë së bashku;
- f. vepra penale është paraprirë ose shoqëruar nga nivele ekstreme dhune;
- g. vepra është kryer me përdorimin ose kërcënimin e armës;
- h. vepra penale ka shkaktuar dëmtim të rëndë fizik ose psikologjik të viktimës;
- i. autori është dënuar më parë për vepra penale të një natyre të ngjashme.

Neni 47 – Dënimet e dhëna nga Pala tjetër

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të parashikuar mundësinë e marrjes parasysh të vendimeve të formës së prerë të marra nga Pala tjetër në lidhje me veprat penale të përcaktuara në pajtim me këtë Konventë në përcaktimin e dënimit.

Neni 48 – Ndalimi i proceseve të detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve ose dënimit

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të ndaluar proceset e detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve, duke përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin, në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.
2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që nëse urdhërohet pagesa e një gjobe, të merret në konsideratë aftësia e autorit të veprës penale për të marrë përsipër detyrimet e tij ose të saj financiare ndaj viktimës.

Kapitulli VI – Hetimi, ndjekja penale, ligji procedural dhe masat mbrojtëse

Neni 49 – Detyrimet e përgjithshme

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që hetimet dhe procedimet gjyqësore në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente të kryhen pa vonesë të panevojshme ndërsa merren parasysh të drejtat e viktimës gjatë të gjitha fazave të procedimeve penale.
2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera, në përputhje me parimet themelore të të drejtave të njeriut dhe duke marrë parasysh perceptimin gjinor të dhunës, për të siguruar hetim dhe ndjekje penale efektive të veprave penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

Neni 50 – Reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëhershme

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit të përgjigjen ndaj të gjitha formave të dhunës të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme duke ofruar mbrojtje të mjaftueshme dhe të menjëhershme për viktimat.

2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit të angazhohen menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme në parandalimin dhe mbrojtjen kundër të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti kësaj Konvente, duke përfshirë përdorimin e masave parandaluese operationale dhe mbledhjen e provave.

Neni 51 – Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që një vlerësim i rrezikut vdekjeprurës, seriozitetit të situatës dhe rrezikut të dhunës së përsëritur të kryhet nga të gjitha autoritetet përkatëse për të menaxhuar rrezikun dhe nëse është e nevojshme për të siguruar mbështetje dhe siguri të koordinuar.
2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që vlerësimi i përmendur në paragrafin 1 merr parasysh siç duhet, në të gjitha fazat e hetimit dhe zbatimit të masave mbrojtëse, faktin se autorët e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konventë zotërojnë ose kanë akses të armëve të zjarrit.

Neni 52 – Urdhrat e jashtëzakonshëm të ndalimit

Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që autoriteteve kompetente u është dhënë fuqia për të urdhëruar, në situata të rrezikut të menjëhershëm, autorin e dhunës në familje që të lërë vendbanimin e viktimës ose personit në rrezik për një periudhë të mjaftueshme kohe dhe të ndalojë autorin të hyjë në vendbanimin e ose kontaktojë viktimën ose personin në rrezik. Masat e marra në zbatim të këtij neni, i japin përparësi sigurisë së viktimave apo personave në rrezik.

Neni 53 – Urdhra shtrëngues dhe mbrojtës

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që urdhra të përshtatshëm shtrëngues dhe mbrojtës

janë të vlefshme për viktimat e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që urdhrat shtrënguese ose mbrojtës të përmendur në paragrafin 1 janë:
 - të vlefshëm për mbrojtje të menjëhershme dhe pa barrierat e panevojshme financiare apo administrative, të vendosura mbi viktimën;
 - lëshohen për një periudhë të caktuar, ose derisa të modifikohen ose të përmbushen;
 - kur është e nevojshme, lëshohen në bazë *ex parte* që ka efekt të menjëhershëm;
 - të vlefshëm pavarësisht nga, ose krahas, procedimeve të tjera ligjore;
 - lejohen të paraqiten në procedimet ligjore të mëtejshme.
3. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që shkeljet e urdhrave shtrëngues ose mbrojtës të nxjerra në pajtim me paragrafin 1 i nënshtrohen sanksioneve penale ose të tjera ligjore efektive, proporcionale dhe frenuese.

Neni 54 – Hetimet dhe prova

Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që, në çdo procedim civil apo penal, provat në lidhje me historinë seksuale dhe sjellje të viktimës lejohen vetëm kur është e përshtatshme dhe e nevojshme.

Neni 55 – Procedimet ex parte dhe ex officio

1. Palët sigurojnë që hetimet ose ndjekja penale e veprave penale të parashikuara në përputhje me nenet 35, 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente nuk do të jenë tërësisht të varura nga një raport ose ankesë e paraqitur nga një viktimë, nëse vepra penale ishte kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj, dhe se procedimi mund të vazhdojë edhe nëse viktima e tërheq deklaratën ose ankesën e tij ose saj.

2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, mundësinë për organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare dhe këshilltarët mbi dhunën në familje për të ndihmuar dhe / ose mbështetur viktimat, me kërkesë të tyre, gjatë hetimeve dhe procedimeve gjyqësore në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

Neni 56 – Masat e mbrojtjes

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë, në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedimeve gjyqësore, në veçanti:
 - a. duke ofruar mbrojtjen e tyre, si dhe atë të familjeve të tyre dhe të dëshmitarëve, nga hakmarrja, kërcënimi dhe viktimizimi i përsëritur;
 - b. duke siguruar që viktimat të informohen, të paktën në rastet kur viktima dhe familja mund të jetë në rrezik, kur autori i veprës arratiset ose lirohet përkohësisht ose përfundimisht;
 - c. duke i informuar ata, sipas kushteve të parashikuara nga ligji i brendshëm, për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion të tyre dhe shqyrtimin e ankesës së tyre, akuzat, ecurinë e përgjithshme të hetimit ose të procedimit, dhe rolin e tyre në to, si dhe rezultatit e çështjes së tyre;
 - d. duke bërë të mundur që viktimat, në mënyrë të pajtueshme me rregullat procedurale të ligjit të brendshëm, të dëgjohen, të sigurojnë prova dhe të paraqesin pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërmjetësi, si dhe marrjen e tyre në shqyrtim;
 - e. duke u siguruar viktimave shërbime mbështetëse të duhura në mënyrë që të drejtat dhe interesat e tyre të paraqiten siç duhet dhe të merren parasysh;
 - f. duke siguruar që masat mund të miratohen për të mbrojtur jetën private dhe imazhin e viktimës;

- g. duke siguruar që kontakti ndërmjet viktimave dhe autorëve të veprës brenda gjykatës dhe zyrave të agjencisë së zbatimit të ligjit të shmanget kur është e mundur;
 - h. duke u siguruar viktimave përkthyes të pavarur dhe kompetentë, kur viktimat janë palë në procedim ose kur ata sigurojnë prova;
 - i. duke bërë të mundur që viktimat të dëshmojnë, sipas rregullave të parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, në sallën e gjyqit pa qenë të pranishëm ose të paktën pa praninë e autorit të dyshuar të veprës, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përshtatshme të komunikimit, kur janë në dispozicion.
2. Një fëmijë viktimë dhe dëshmitar i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje i sigurohen, kur është e përshtatshme, masa të posaçme mbrojtjeje duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës.

Neni 57 – Ndhimë ligjore

Palët sigurojnë të drejtën për ndihmë juridike dhe ndihmë ligjore falas për viktimat sipas kushteve të parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm.

Neni 58 - Parashkrimi

Palët marrin masat e nevojshme legjislative dhe të tjera për të siguruar që parashkrimi për fillimin e çdo procedimi ligjor në lidhje me veprat penale të parashikuara në përputhje me Nenet 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente, do të vazhdojë për një periudhë kohore që është e mjaftueshme dhe proporcionale me seriozitetin e veprës në fjalë, për të lejuar fillimin efikas të procedimeve, pasi viktima ka arritur moshën madhore.

Kapitulli VII – Emigrimi dhe azili

Neni 59 – Statusi i vendbanimit

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që viktimave vendbanimi i të cilëve varet nga statusi

i bashkëshortit ose partnerit siç njihet nga ligji i brendshëm, në rast të zgjidhjes së martesës ose marrëdhënies, u jepet në rast të rrethana veçanërisht të vështira, me kërkesë, një leje qëndrimi autonom, pavarësisht nga kohëzgjatja e martesës apo marrëdhënies. Kushtet në lidhje me dhënien dhe kohëzgjatjen e lejes së qëndrimit autonom parashikohen nga ligji i brendshëm.

2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të garantuar që viktimat mundtë sigurojnë pezullimin e procedurave të dëbimit të filluara në lidhje me një status vendbanimi të varur nga ajo e bashkëshortit ose partnerit siç njihet nga ligji i brendshëm për t'u dhënë atyre mundësinë që të aplikojnë për një leje qëndrimi autonom.
3. Palët lëshojnë një leje qëndrimi të rinovueshme për viktimat në një nga dy situatat e mëposhtme, ose në të dyja:
 - a. kur autoriteti kompetent gjykon se qëndrimi i tyre është i nevojshëm për shkak të situatës së tyre personale;
 - b. kur autoriteti kompetent gjykon se qëndrimi i tyre është i nevojshëm me qëllim të bashkëpunimit të tyre me autoritetet kompetente në hetim ose procedimin penal.
4. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që viktimat e martesës së detyruar të sjellë në një shtet tjetër, për qëllim martesë dhe të cilët, si rezultat, kanë humbur statusin e tyre të vendbanimit në shtetin ku ata zakonisht banojnë, mund të rifitojnë këtë status.

Neni 60 – Kërkesat për azil me bazë gjinore

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar se dhuna me bazë gjinore kundër grave mund të njihet si një formë persekutimi brenda kuptimit të Nenit 1, A (2), të Konventës së vitit 1951 lidhur me Statusin e Refugjatëve dhe si një formë e dëmtimit të rëndë që shkakton mbrojtje plotësuese / mbështetëse.
2. Palët sigurojnë që një interpretim me ndjeshmëri gjinore të jepet për secilin nga arsyet e Konventës dhe se aty ku është

përcaktuar që persekutimi i mundshëm ndodh për një ose më shumë nga këto arsye, aplikuesve do t'u jepet statusi i refugjatëve në bazë të instrumenteve të zbatueshme përkatëse.

3. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të zhvilluar procedurat e pranimit dhe shërbime mbështetëse me ndjeshmëri gjinore për azilkërkuesit si dhe udhëzimet gjinore dhe procedurat për azil me ndjeshmëri gjinore, duke përfshirë përcaktimin e statusit të refugjatëve dhe kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare.

Neni 61 – Mbrojtja e refugjatëve

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të respektuar parimin e mbrojtjes së refugjatëve në përputhje me detyrimet ekzistuese sipas ligjit ndërkombëtar.
2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që viktimat e dhunës ndaj grave që kanë nevojë për mbrojtje, pavarësisht nga statusi ose vendbanimi i tyre, nuk do të kthehen nën asnjë rrethanë në çdo vend ku jeta e tyre do të ishte në rrezik ose ku ata mund t'i nënshtrohen torturës ose trajtimit çnjerëzor ose degradues apo dënimit.

Kapitulli VIII – Bashkëpunimi ndërkombëtar

Neni 62 – Parimet e përgjithshme

1. Palët bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, dhe përmes zbatimit të instrumenteve përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale për bashkëpunimin në çështje civile dhe penale, marrëveshjeve të arritura në bazë të legjislacionit uniform ose reciprok dhe ligjeve të brendshme, në masën më të gjerë të mundshme, me qëllim:
 - a. parandalimin, luftën dhe ndjekjen penale të të gjitha formave të dhunës që mbulohen nga objekti i kësaj Konvente;
 - b. mbrojtjen dhe sigurimin e ndihmës për viktimat;

- c. hetimin ose procedimin në lidhje me veprat penale të parashikuara në përputhje me këtë Konventë;
 - d. zbatimin e vendimeve përkatëse civile dhe penale, të lëshuara nga autoritetet gjyqësore të Palëve, duke përfshirë urdhrat mbrojtës.
2. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që viktimat e një vepre penale të parashikuar në pajtim me këtë Konventë dhe të kryer në territorin e një Pale të ndryshëm nga ai ku ata banojnë, mund të bëjnë një ankesë para autoriteteve kompetente të Shtetit të tyre të vendbanimit.
3. Nëse një Palë që ofron ndihmë të ndërsjellë juridike në çështje penale, ekstradimin ose zbatimin e vendimeve civile ose penale të dhëna nga një Palë tjetër në këtë Konventë të kushtëzuar nga ekzistenca e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për bashkëpunim të tillë juridik nga një Palë, me të cilin nuk palidhur një marrëveshje të tillë, ajo mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale, ekstradimin ose zbatimin e vendimeve civile ose penale të dhëna nga Pala tjetër në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.
4. Palët përpiqen të harmonizojnë, kur është e përshtatshme, parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në programe të asistencës për zhvillim të dhëna në interes të Shteteve të treta, duke përfshirë lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe me Shtete të treta me qëllim lehtësimin e mbrojtjes së viktimave në përputhje me Nenin 18, paragrafi 5.

Neni 63 – Masat që lidhen me personat në rrezik

Kur një Palë, mbi bazën e informacionit në dispozicion të tij, ka arsye të mjaftueshme të besojë se një person është në rrezik të menjëhershëm për të qenë subjekt i ndonjë akti dhune të përmendur

në Nenet 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente në territorin e një Pale tjetër, Pala që ka informacion inkurajohet ta transmetojë atë pa vonesë për këtë të fundit me qëllim që të sigurojë se masat e duhura të mbrojtjes janë marrë. Kur është e zbatueshme, ky informacion do të përfshijë detajet mbi dispozitat ekzistuese të mbrojtjes në interes të personit në rrezik.

Neni 64 – Informimi

1. Pala e kërkuar informon menjëherë Palën kërkuese për rezultatin përfundimtar të masës së ndërmarrë në këtë kapitull. Gjithashtu Pala e kërkuar informon menjëherë Palën kërkuese për çdo rrethanë që e bën të pamundur realizimin e masës së kërkuar ose që mund ta vonojë atë në mënyrë të konsiderueshme.
2. Një Palë mund, brenda kufijve të ligjit të tij të brendshëm, pa kërkesë paraprake, t'i përcjellë Palës tjetër informacionin e marrë në kuadër të hetimeve të saj, kur ajo gjykon se zbulimi i informacioneve të tilla mund të ndihmojë Palën marrëse në parandalimin e veprave penale të parashikuara në përputhje me këtë Konventë ose në fillimin apo kryerjen e hetimeve ose të procedimeve në lidhje me vepra të tilla penale, ose mund të çojë në një kërkesë për bashkëpunim nga kjo Palë sipas këtij kapitulli.
3. Një Palë që merr çdo informacion në përputhje me paragrafin 2 ia paraqet këtë informacion autoriteteve kompetente të saj, në mënyrë që të ndërmerren procedime nëse ato konsiderohen të përshtatshme, ose që ky informacion të merret në konsideratë në lidhje me procedimet përkatëse civile dhe penale.

Neni 65 – Mbrojtja e të dhënave

Të dhënat personale ruhen dhe përdoren në përputhje me detyrimet e ndërmarra nga Palët në bazë të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ETS nr 108).

Kapitulli IX – Mekanizmi i monitorimit

Neni 66 – Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

1. Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (më poshtë referuar si “GREVIO”) monitoron zbatimin e kësaj Konvente nga Palët.
2. GREVIO përbëhet nga një minimum prej 10 anëtarësh dhe një maksimum prej 15 anëtarësh, duke marrë parasysh një balancë gjinore dhe gjeografike, si dhe ekspertizën multidisiplinore. Anëtarët e saj zgjidhen nga Komiteti i Palëve nga radhët e kandidatëve të nominuar nga Palët për një mandat prej katër vjetësh, i rinovueshëm një herë, dhe zgjidhen nga shtetasit e Palëve.
3. Zgjedhja fillestare e 10 anëtarëve, mbahet brenda një periudhe prej një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Zgjedhja e 5 anëtarëve shtesë mbahet pas ratifikimit ose aderimit të 25-të.
4. Zgjedhja e anëtarëve të GREVIO bazohet në parimet e mëposhtme:
 - a. Ata zgjidhen në bazë të një procedure transparente nga radhët e personave me karakter të lartë moral, të njohur për kompetencën e tyre të pranuar në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, ose të ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave, ose që kanë demonstruar përvojë profesionale në fushat e mbuluara nga kjo Konventë;
 - b. Dy anëtarë të GREVIO nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit Shtet;
 - c. Ata duhet të përfaqësojnë sistemet kryesore ligjore;
 - d. Ata duhet të përfaqësojnë aktorët dhe agjencitë përkatëse në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
 - e. Ata veprojnë në kapacitetin e tyre individual dhe janë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre, dhe janë në dispozicion për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive.
5. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të GREVIO përcaktohet nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, pas konsultimit dhe

marrjes së pëlqimit unanim të Palëve, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

6. GREVIO miraton rregullat e veta të procedurës.
7. Anëtarët e GREVIO, dhe anëtarë të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende, siç përcaktohet në Nenin 68, paragrafët 9 dhe 14, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në shtojcën e kësaj Konvente.

Neni 67 – Komiteti i Palëve

1. Komiteti i Palëve përbëhet nga përfaqësuesit e Palëve në Konventë.
2. Komiteti i Palëve mblidhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës. Takimi i tij parë zhvillohet brenda një periudhe prej një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në mënyrë që të zgjedhë anëtarët e GREVIO. Ai takohet më pas sa herë që një e treta e Palëve, Presidenti i Komitetit të Palëve ose Sekretari i Përgjithshëm kërkojnë këtë.
3. Komiteti i Palëve miraton rregullat e veta të procedurës.

Neni 68 – Procedura

1. Palët i dorëzojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, bazuar në një pyetësor të përgatitur nga GREVIO, një raport mbi masat legjislative dhe të tjera që i bëjnë dispozitat e kësaj Konvente të zbatueshme, për shqyrtim nga GREVIO.
2. GREVIO merr në shqyrtim raportin e paraqitur në përputhje me paragrafin 1 me përfaqësues të Palës së interesuar.
3. Procedurat e vlerësimit të mëtejshëm ndahen në raunde, kohëzgjatja e së cilës përcaktohet nga GREVIO. Në fillim të çdo raundi GREVIO zgjedh dispozitat e veçanta mbi të cilat bazohet procedura e vlerësimit dhe dërgon një pyetësor.
4. GREVIO përcakton mjetet e duhura për të kryer këtë procedure monitorimi. Ajo në veçanti mund të miratojë një pyetësor për çdo raund vlerësimi, e cila shërben si një bazë për procedurën

- e vlerësimit të zbatimit nga Palët. Ky pyetësor i drejtohet të gjitha Palëve. Palët i përgjigjen këtij pyetësori, si dhe çdo kërkesë tjetër për informacion nga GREVIO.
5. GREVIO mund të marrë informacion mbi zbatimin e Konventës nga organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile, si dhe nga institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
 6. GREVIO shqyrton siç duhet informacionin ekzistues në dispozicion nga instrumentet dhe organet e tjera rajonale dhe ndërkombëtare në fushat që hyjnë brenda objektivit të kësaj Konvente.
 7. Kur miratohet një pyetësor për çdo raund vlerësimi, GREVIO i kushton vëmendje të duhur mbledhjes së të dhënave ekzistuese dhe kërkimit shkencor nga Palët, siç përmendet në Nenin 11 të kësaj Konvente.
 8. GREVIO mund të marrë informacion mbi zbatimin e Konventës nga Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Asambleja Parlamentare dhe organet përkatëse të specializuara të Këshillit të Evropës, si edhe ato të krijuara në bazë të instrumenteve të tjera ndërkombëtare. Ankesat e paraqitura në këto organe dhe rezultati i tyre i vihen në dispozicion GREVIO.
 9. GREVIO mund të organizojë, në bashkëpunim me autoritetet kombëtare dhe me ndihmën e ekspertëve të pavarur kombëtarë, vizita në vende, nëse informacioni i marrë është i pamjaftueshëm, ose në rastet e parashikuara në paragrafin 14. Gjatë këtyre vizitave, GREVIO mund të asistohet nga specialistë në fusha të veçanta.
 10. GREVIO përgatit një projekt raport që përmban analizën e saj në lidhje me zbatimin e dispozitave mbi të cilat bazohet vlerësimi, si dhe sugjerimet dhe propozimet e saj në lidhje me mënyrën në të cilën Pala e interesuar mund të trajtojë problemin që janë identifikuar. Projekt raporti i dërgohet për komente Palës që i nënshtrohet vlerësimit. Komentet e saj merren parasysh nga GREVIO kur miraton raportin e tij.

11. Në pazëtë të gjitha informacioneve të marra dhe komenteve nga Palët, GREVIO miraton raportin dhe konkluzionet e tij lidhur me masat e marra nga Pala e interesuar për të zbatuar dispozitat e kësaj Konvente. Ky raport dhe konkluzionet i dërgohen Palës së interesuar dhe Komitetit të Palëve. Raporti dhe konkluzione të GREVIO bëhen publike, që nga miratimi i tyre, së bashku me komentet e mundshme nga Pala e interesuar.
12. Pa cenuar procedurëneparagrafëve1 deri në 8, Komiteti i Palëve mund të miratojë, në bazë të raportit dhe konkluzioneve të GREVIO, rekomandimet drejtuar kësaj Pale(a) në lidhje me masat që duhen marrë për zbatimin konkluzione vetë GREVIO, nëse është e nevojshme duke caktuar një datë për paraqitjen e informacioneve mbi zbatimin e tyre, dhe (b) duke synuar nxitjen e bashkëpunimit me atë Palë për zbatimin e duhur të kësaj Konvente.
13. Në qoftë se GREVIO merr informacion të besueshëm që tregon një situatë ku problemet kërkojnë vëmendje të menjëhershme për të parandaluar ose kufizuar shkallën ose numrin e shkeljeve të rënda të Konventës, ajo mund të kërkojë paraqitjen e menjëhershme të një raporti të veçantë në lidhje me masat e marra për të parandaluar një model serioz, në masë ose të vazhdueshme të dhunës ndaj grave.
14. Duke pasur parasysh informacionin e paraqitur nga Pala e interesuar, si dhe çdo informacion tjetër të besueshëm në dispozicion të tij, GREVIO mund të caktojë një ose më shumë nga anëtarët e tij për të kryer një hetim dhe për të raportuar menjëherë në GREVIO. Kur garantohet dhe me pëlqimin e Palës, hetimi mund të përfshijë një vizitë në territorin e saj.
15. Pas shqyrtimit të rezultateve të hetimit të referuar në paragrafin 14, GREVIO ia transmeton këto rezultate Palës së interesuar dhe, kur është e përshtatshme, Komitetit të Palëve dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës së bashku me komentet dhe rekomandimet.

Neni 69 – Rekomandime të përgjithshme

GREVIO mund të miratojë, kur është e përshtatshme, rekomandime të përgjithshme mbi zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 70 - Përfshirja parlamentare në monitorim

1. Parlamentet kombëtare ftohen të marrin pjesë në monitorimin e masave të marra për zbatimin e kësaj Konvente.
2. Palët paraqesin raportet e GREVIO në parlamentet e tyre kombëtare.
3. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ftohet të bëjë rregullisht vlerësime mbi zbatimin e kësaj Konvente.

Kapitulli X – Marrëdhëniet me instrumentet e tjera ndërkombëtare

Neni 71 – Marrëdhëniet me instrumentet e tjera ndërkombëtare

1. Kjo Konventë nuk i cenon detyrimet që rrjedhin nga instrumentet e tjera ndërkombëtare në të cilat Palët në këtë Konventë janë Palë ose bëhen Palë dhe të cilat përmbajnë dispozita mbi çështje të rregulluara nga kjo Konventë.
2. Palët në këtë Konventë mund të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me njëri-tjetrin në çështje që trajtohen në këtë Konventë, me qëllim plotësimin ose përforcimin e dispozitave të tij ose lehtësimin e zbatimit të parimeve të shprehura në të.

Kapitulli XI – Amendimet e Konventës

Neni 72 – Amendimet

1. Çdo propozim për amendim të kësaj Konvente të paraqitur nga një Palë i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës dhe i përcillet nga ana e saj apo e tij Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, çdo nënshkruesi, çdo Pale, Bashkimit

Evropian, çdo Shteti të ftuar për nënshkrimin e kësaj Konvente në përputhje me dispozitat e Nenit 75, dhe çdo Shteti të ftuar për aderim në këtë Konventë në përputhje me dispozitat e Nenit 76.

2. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës shqyrton amendimin e propozuar dhe, pas konsultimit të Palëve në këtë Konvente që nuk janë anëtarë të Këshillit të Evropës, mund të miratojë mendimin me shumicë ne parashikuar në Nenin 20. datë Statutit të Këshillit të Evropës.
3. Teksti i çdo amendimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave, në përputhje me paragrafin 2, u përcillet Palëve për pranim.
4. Çdo amendim i miratuar në përputhje me paragrafin 2 hyn në fuqinë ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe një mujore pas datës në të cilën të gjitha Palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tyre.

Kapitulli XII – Dispozitat përfundimtare

Neni 73 – Efektet e kësaj Konvente

Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë dispozitat e ligjit të brendshëm dhe instrumentet detyruese ndërkombëtare, të cilat janë tashmë në fuqi ose mund të hyjnë në fuqi, sipas të cilave të drejta më të favorshme u janë dhënë ose do t'u jepen personave në parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Neni 74 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët në çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin ose interpretimin e dispozitave të kësaj Konvente së pari duhet të kërkojnë ta zgjidhin atë me anë të bisedimit, pajtimit, arbitrazhit ose me çdo metodë tjetër të zgjidhjes paqësore të pranuar me marrëveshje të përbashkët ndërmjet tyre.
2. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës mund të përcaktojë procedurat e zgjidhjes që të jenë në dispozicion për përdorim

nga Palët në mosmarrëveshje nëse ata do të binin dakord për këtë.

Neni 75 – Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, Shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj dhe Bashkimi Evropian.
2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
3. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tre mujore pas datës në të cilën 10 nënshkruesit, duke përfshirë të paktën 8 Shtete anëtare të Këshillit të Evropës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur nga Konventa në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.
4. Në lidhje me çdo Shtet të referuar në paragrafin 1 apo Bashkimin Evropian, i cili shpreh më vonë pëlqimin e tij për t'u lidhur me të, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tre mujore pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

Neni 76 – Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, pas konsultimit të Palëve në këtë Konventë dhe marrjen e pëlqimit të tyre unanim, mund të ftojë çdo Shtet joanëtar të Këshillit të Evropës, e cila nuk ka marrë pjesë në hartimin e Konventës, për të aderuar në këtë Konventë me një vendim të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Evropës, dhe me votë unanime të përfaqësuesve të palëve të drejtë për t'u ulur në Komiteti i Ministrave.
2. Në lidhje me çdo shtet aderues, Konventa do të hyjë në fuqinë ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 77 – Zbatimi territorial

1. Çdo Shtet apo Bashkimi Evropian mund, në kohën e nënshkrimit apo kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të caktojë territorin ose territoret në të cilat zbatohet kjo Konventë.
2. Çdo Palë mund, në çdo datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të specifikuar në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ajo është përgjegjëse ose në emër të të cilëve ajo është e autorizuar për të ofruar garanci. Në lidhje me këtë territor, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së kësaj deklarate nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm mund, në lidhje me çdo territor të caktuar në atë deklaratë, të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja hyn në fuqinë ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 78 – Rezervat

1. Asnjë rezervë nuk mund të bëhet në lidhje me çdo dispozitë të kësaj Konvente, me përjashtimet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3.
2. Çdo shtet ose Bashkimi Evropian mund, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të deklarojë që ai rezervon të drejtën të mos zbatojë ose të zbatojë vetëm në raste ose kushte të caktuara dispozitat e parashtruara në:
 - Nenin30, paragrafi 2;
 - Nenin44, paragrafët 1.e, 3 dhe 4;
 - Nenin55, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 35 përshkeljet e lehta;

- Nenin 58 nëlidhje me Nenet 37, 38 dhe 39;
 - Nenin 59.
3. Çdo shtet ose Bashkimi Evropian mund, në kohën e nënshkrimit apo kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të deklarojë që ai rezervon të drejtën të parashikojë sanksione jo-penale, në vend të sanksioneve penale, për sjellje të referuara në Nenet 33 dhe 34.
 4. Çdo Palë mund ta tërheqë tërësisht ose pjesërisht një rezervë me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Kjo deklaratë hyn në fuqi që nga data e marrjes së saj nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 79 – Vlefshmëria dhe shqyrtimi i rezervave

1. Rezervate përmendura në Nenin 78, paragrafët 2 dhe 3, janë të vlefshme për një periudhë prej pesë vjetësh nga dita e hyrjes në fuqitë kësaj Konvente në lidhje me Palën e interesuar. Sidoqoftë, këto rezerva mund të rinovohen për periudha me kohëzgjatje të njëjtë.
2. Tetëmbëdhjetë muaj para datës së mbarimit të afatit të rezervës, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton për mbarimin e këtij afati Palën e interesuar. Jo më vonë se tre muaj para mbarimit të afatit, Pala njofton Sekretarin e Përgjithshëm se ajo do e mbajë, ndryshojë ose tërheqë rezervën e saj. Në mungesë të një njoftimi nga Pala e interesuar, Sekretariati i Përgjithshëm informon atë Palë se rezerva e saj konsiderohet të jetë zgjatur automatikisht për një periudhë prej gjashtë muajsh. Mos njoftimi nga Pala e interesuar për qëllimin e saj për të mbajtur ose modifikuar rezervën e saj para mbarimit të kësaj periudhe bën që rezerva të mos jetë më e vlefshme.
3. Nëse një Palë bën një rezervë në përputhje me Nenin 78, paragrafët 2 dhe 3, ajo jep, para rinovimit të saj ose me kërkesë, një shpjegim për GREVIO, mbi arsyet që justifikojnë vazhdimin e saj.

Neni 80 – Denoncimi

1. Çdo Palë mund, në çdo kohë, të denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
2. Denoncimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 81 – Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, Shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj, çdo nënshkrues, çdo Palë, Bashkimin Evropian, dhe çdo shtet të ftuar për aderim në këtë Konventë për:

- a. çdo nënshkrim;
- b. depozitim të çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;
- c. çdo datë të hyrjes në fuqitë kësaj Konvente në përputhje me Nenit 75 dhe 76;
- d. çdo amendim të miratuar në përputhje me Nenin 72 dhe datën në të cilën amendimi hyn në fuqi;
- e. çdo rezervë dhe tërheqje të rezervës të bërë në zbatim të Nenit 78;
- f. çdo denoncim të bërë në zbatim të dispozitave të Nenit 80;
- g. çdo akt tjetër, njoftim apo komunikim në lidhje me këtë Konventë.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në [Stamboll], më [11] [Maj 2011], në anglisht dhe frëngjisht, ku të dy tekset janë njëllor autentike, në një kopje të vetme e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës i transmeton kopje të vërtetuara secilit prej Shteteve anëtare të Këshillit të Europës, Shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente, Bashkimit Evropian dhe çdo Shteti të ftuar për aderim në këtë Konventë.

Shtojca – Privilegjet dhe imunitetet (Neni 66)

1. Kjo shtojcë zbatohet për anëtarët e GREVIO të përmendur në Nenin 66 të Konventës, si dhe për anëtarët e tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende. Për qëllim të kësaj shtojce, termi “anëtarët e tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende” përfshin ekspertë të pavarur vendas dhe specialistët të përmendur në Nenin 68, paragrafi 9, të Konventës, anëtarët e stafit të Këshillit të Evropës dhe përkthyesit e punësuar nga Këshilli i Evropës që shoqërojnë GREVIO gjatë vizitave të saj në vende.
2. Anëtarët e GREVIO dhe anëtarët e tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në lidhje me përgatitjen dhe kryerjen e vizitave në vende, si dhe ndjekjen e tyre, dhe që udhëtojnë në lidhje me këto funksione, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:
 - a. Imunitet ndaj arrestimit ose ndalimit dhe ndaj sekuestrimit të bagazheve të tyre personale, dhe imunitet ndaj procesit ligjor të çdo lloji në lidhje me fjalët e folura ose të shkruara dhe të gjitha aktet e realizuara nga ata në cilësinë zyrtare;
 - b. Përjashtim nga çdo kufizim të lirisë së lëvizjes në dalje nga dhe kthim në vendin e tyre të vendbanimit, dhe hyrjet e daljet nga vendi në të cilin ata ushtrojnë funksionet e tyre, dhe nga regjistrimi i të huajve në vendin të cilin ata po vizitojnë, ose nëpërmjet të cilinat apo kalojnë në ushtrim të funksioneve të tyre;
3. Gjatë udhëtimeve të ndërmarra në ushtrim të funksioneve të tyre, anëtarëve të GREVIO dhe anëtarëve të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende, në çështje të kontrollit doganor dhe të këmbimit, u jepen të njëjtat lehtësi si ato që u jepen përfaqësuesve të qeverive të huaja në detyrë të përkohshme zyrtare.
4. Dokumentet në lidhje me vlerësimin e zbatimit të Konventës të kryer nga anëtarët e GREVIO dhe anëtarë të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende janë të pacenueshme për aq sa ato lidhen me aktivitetin e GREVIO. Asnjë pengesë

apo censurë nuk zbatohet ndaj korrespondencës zyrtare të GREVIO ose komunikimeve zyrtare të anëtarëve të GREVIO dhe anëtarëve të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende.

4. Për t'ju siguruar anëtarëve të GREVIO dhe anëtarëve të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende, lirinë e plotë të fjalës dhe pavarësinë e plotë në përmbushjen e detyrave të tyre, imuniteti ndaj procesit ligjor në lidhje me fjalët e folura ose të shkruara dhe të gjitha veprimet e kryera prej tyre në përmbushjen e detyrave të tyre vazhdon t' u jepet, pavarësisht se personat në fjalë nuk janë më të angazhuar me përmbushjen e detyrave të tilla.
5. Privilegjet dhe imunitetet u jepen personave të përmendur në paragrafin 1 të kësaj shtojce në mënyrë që të garantojnë ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre në interes të GREVIO dhe jo për përfitimin e tyre personal. Heqja e imuniteteve të personave të përmendur në paragrafin 1 të kësaj shtojce bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës në çdo rast kur, sipas mendimit të tij ose të saj, imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë dhe kur ajo mund të hiqet pa cenuar interesat e GREVIO.

Shtojca II

Lista e rezolutave dhe rekomandimeve të Asamblesë së Parlamentare për dhunën ndaj grave (2000-2012)

- ▶ Rezoluta 1861 (2012) për promovimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje”
- ▶ Rezoluta 1852 (2011) për dhunën psikologjike
- ▶ Rezoluta 1853 (2011) për urdhrat e mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje
- ▶ Opinioni 280 (2011) për projekt-konventën “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje”
- ▶ Rezoluta 1765 dhe Rekomandimi 1940 (2010) për kërkesat për azil të lidhura me përkatësinë gjinore
- ▶ Rezoluta 1714 dhe Rekomandimi 1905 (2010) për fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës në familje
- ▶ Rezoluta 1697 dhe Rekomandimi 1891 (2009) për gratë migruese: në risk të veçantë të dhunës në familje
- ▶ Rezoluta 1691 dhe Rekomandimi 1887 (2009) për përdhunimin e grave, përfshirë edhe përdhunimin në lidhjen martesore
- ▶ Rezoluta 1681 dhe Rekomandimi 1881 (2009) për nevojën e ngutshme për të luftuar të ashtuquajturit “krime për të mbrojtur nderin”
- ▶ Rezoluta 1670 dhe Rekomandimi 1873 (2009) për dhunën seksuale ndaj grave gjatë konflikteve të armatosura
- ▶ Rezoluta 1662 dhe Rekomandimi 1868 (2009) për veprimin për të luftuar shkeljet e të drejtave të njeriut të lidhura me përkatësinë gjinore, duke përfshirë edhe rrëmbimin e grave dhe vajzave

- ▶ Rezoluta 1654 dhe Rekomandimi 1861 (2009) për feminicitet
- ▶ Rezoluta 1635 dhe Rekomandimi 1847 (2008) për luftën kundër dhunës ndaj grave: drejt një konvente të Këshillit të Evropës
- ▶ Rezoluta 1582 dhe Rekomandimi 1817 (2007) për parlamentet e bashkuara në luftën kundër dhunës në familje ndaj grave: vlerësimi i progresit të fushatës
- ▶ Rekomandimi 1777 (2007) për sulmet seksuale të lidhura me “drogat e përdorura për të arritur përdhunim gjatë një takimi dashurie”
- ▶ Rezoluta 1512 dhe Rekomandimi 1759 (2006) për parlamentet e bashkuara në luftën kundër dhunës në familje ndaj grave
- ▶ Rekomandimi 1723 (2005) për martesat e detyruara dhe martesat e fëmijëve
- ▶ Rekomandimi 1681 (2004) për fushatën për të luftuar dhunën ndaj grave në Evropë
- ▶ Rezoluta 1327 (2003) për të ashtuquajturit “krime për të mbrojtur nderin”
- ▶ Rekomandimi 1582 (2002) për dhunën në familje ndaj grave
- ▶ Rezoluta 1247 (2001) për gjymtimin e organeve gjenitale femërore
- ▶ Rekomandim 1450 (2000) për dhunën ndaj grave në Evropë

Shtojca III

Lista e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në lidhje me dhunën ndaj grave

- ▶ “V.C. kundër Sllovakisë”, 2011
- ▶ “Yazgül Yilmaz kundër Turqisë”, 2011
- ▶ “Ebcin kundër Turqisë”, 2011
- ▶ “Izevbekhai kundër Irlandës”, 2011
- ▶ “Omeredo kundër Austrisë”, 2011
- ▶ “Hajduová kundër Sllovakisë”, 2010
- ▶ “A. kundër Kroacisë”, 2010
- ▶ “N. kundër Suedisë”, 2010
- ▶ “E.S. e të tjerë kundër Sllovakisë”, 2009
- ▶ “Opuz kundër Turqisë”, 2009
- ▶ “Branko Tomašić e të tjerë kundër Kroacisë”, 2009
- ▶ “Bevacqua dhe S. kundër Bullgarisë”, 2008
- ▶ “Maslova dhe Nalbandov kundër Rosisë”, 2008
- ▶ “Kontrova kundër Sllovakisë”, 2007
- ▶ “M.C. kundër Bullgarisë”, 2003
- ▶ “Aydin kundër Turqisë”, 1997
- ▶ “X. dhe Y. kundër Vendeve të Ulëta”, 1985

Shtojca IV

Lista e instrumenteve dhe standardeve të tjera ndërkombëtare që lidhen me këtë Konvente

- ▶ Këshilli i Evropës, Rekomandim (2002)5 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për mbrojtjen e grave nga dhuna
- ▶ Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe Protokollit Fakultativ të saj
- ▶ Rekomandim i Përgjithshëm nr. 19 i Komitetit CEDAW “Për dhunën ndaj grave”
- ▶ Konventa e OKB-së për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe Protokollet Fakultative të saj
- ▶ Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për Eliminimin e Dhunës Ndaj Grave
- ▶ Konventa ndëramerikane “Për parandalimin, ndëshkimin dhe eliminimin e dhunës ndaj grave” (Konventa e Belem do Paras)
- ▶ Protokollit i Kartës Afrikane Për të drejtat e Njeriut dhe të Popujve lidhur me të Drejtat e Grave në Afrikë” (Protokollit i Maputos)

Përse duhet mbështetur Konventa e Stambollit?

- ▶ si qëndrim politik, për të dhënë një mesazh të qartë dhe të pakthyeshëm se, si ligjvënës, dhunën ndaj grave e konsiderojmë si krim dhe si shkelje të të drejtave të njeriut, dhe se nuk jemi të gatshëm ta lëmë pa e dënuar, ta justifikojmë apo ta minimizojmë;
- ▶ sepse në të përjashtohet mundësia për ta përdorur kulturën, zakonet, fenë apo të ashtuquajturin “nder” si justifikim për aktet e dhunës;
- ▶ sepse synon t’i ndryshojë sjelljet dhe stereotipat gjinorë që e bëjnë të pranueshme dhunën ndaj grave;
- ▶ sepse do të jetë e efektshme në luftimin e dhunës ndaj grave, duke qenë se mbështetet në një qasje të bashkënduar, ku merren në konsideratë njëkohësisht parandalimi, mbrojtja, ndjekja penale dhe politikat e integruara;
- ▶ sepse i mbulon të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe mund të zbatohet edhe për viktimat e tjera të dhunës në familje, duke përfshirë edhe fëmijët, burrat dhe të moshuarit;
- ▶ sepse synon të garantojë standarde minimale, duke lejuar mundësinë që shtetet të mbajnë në fuqi ose të miratojnë standarde më mbrojtëse;
- ▶ sepse zbatimi i saj do të monitorohet nga një mekanizëm i fuqishëm dhe i pavarur;
- ▶ sepse, si garanci shtesë për zbatimin e efektshëm të saj, ajo parashikon që në procedurën e monitorimit të përfshihen parlamentet kombëtare;
- ▶ sepse nevoja për një veprim të fortë politik dhe ligjor për ta eliminuar dhunën ndaj grave është e fortë prej kohësh.

Anëtarët e Rrjetit Parlamentar “Gra të lira prej dhunës”

**www.assembly.coe.int/stopviolence/
womenfreefromviolence@coe.int**

